

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6002  
E shtunë, 15 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

16 orë rresht punova  
në Deklaratën e  
Pavarësisë | F. 7



FLET SHKRUESI I  
DEKLARATËS SË  
PAVARËSISË,  
SHYORI NIMANI

Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", AKADEMIK REXHEP QOSJA | F. 4-5

## KOSOVA, NJË SHTET I HALLAKATUR



Akademik Rexhep Qosja në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e 12-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ka thënë se Kosova është një shtet i hallakatur. Qosja ka thënë se e quan të tillë, sepse Kosova ende është pa themele të përcaktuara shtetërore. "Duke mos qenë shtet funksional, po i hallakatur, në Kosovën e sotme sundojnë individët e nuk qeverisin institucionet", ka thënë ai, duke shtuar se në Kosovën e sotme as në ëndërr nuk shihet shteti i së drejtës. Qosja ka theksuar se institucionet e saj të pavarura janë të kapura prej institucioneve të quajtura shtetërore ligjvënëse dhe zbatimore (ekzekutive). Megjithatë, akademik Qosja thotë se me rëndësi të madhe, jetësore dhe historike për shqiptarët, është se Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. Dhe, sipas tij, me rëndësi jetësore dhe historike për shqiptarët është se kjo liri dhe pavarësi e saj është e mbrojtur, e mbrojtur dhe e sot e të shpresojmë edhe nesër prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**Analistët: Edhe në  
12-vjetorin e  
pavarësisë Kosova  
në pozitë jo të mirë**

| F. 3

**Kosova dhe Serbia  
nënshkruajnë marrëveshje për  
hekurudha dhe autostrada.**

| F. 8-9



### AKTUALE



**TRUMPI URON THAÇIN PËR  
12-VJETORIN E PAVARËSISË** | F. 2

**LANSOHET ANALIZA E PULSIT  
PUBLIK PËR PAJTIMIN DHE  
BASHKËJETESËN** | F. 6

### EKONOMI



**OEAK-u: FUQIZIMI EKONOMIK I  
GRAVE, TEJET I RËNDËSISHËM  
PËR ZHVILLIMIN E  
QËNDRUESHËM TË VENDIT** | F. 9

**SUSPENDOHEN NGA PUNA DY  
INSPEKTORË TATIMORË** | F. 9

### KULTURË

**VEPËR ME VLERË ENCIKLOPEDIKE  
NGA FUSHA E DREJTËSISË** | F. 12

Sadri FETIU

### SPORT

**MARMARINOS: DUA TË FITOJ  
ME KOSOVËN** | F. 12



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Haxhiu i drejtohet Konferencës së Hagës për anëtarësimin e Kosovës



PRISHTINË, 14 SHKURT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, i është drejtuar me një letër kërkesë Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private për të shqyrtuar mundësitë e anëtarësimin të Republikës së Kosovës në këtë institucion tejet të rëndësishëm.

“Përmes këtij anëtarësimi, por bazuar edhe në përvojën në anëtarësimet në konventat e këtilla, Ministria e Drejtësisë është e bindur se një gjë e tillë, do të mundësonte zbatimin e unifikuar të konventave ndërkombëtare në çështjet e së drejtës ndërkombëtare private, si dhe do të lehtësonte qasjen

në platforma dhe instrumente multilaterale që kanë të bëjnë me këtë fushë. Për shkak të mosanëtarësimin në Konferencën e Hagës, është vështirësuar zbatimi i së drejtës në çështjet që lidhen me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve, në aspektin civil, si dhe në konteste familjare dhe trashëgimore për

qytetarët e Republikës së Kosovës. Kësisoj, Ministria e Drejtësisë do të punojë me përkushtim në integrimin e Republikës së Kosovës në organizata rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim të lehtësimin në realizimin e të drejtave të qytetarëve të saj”, është thënë në njoftimin për media nga kjo ministri.

## Trumpi uron Thaçin për 12-vjetorin e pavarësisë

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të premten një telegram urimi nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, me rastin e 12-vjetorit të pavarësisë së Kosovës



PRISHTINË, 13 SHKURT (ER)- Presidenti amerikan, Donald Trump ka uruar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi për 12-vjetorin e pavarësisë së shtetit të Kosovës.

Në një telegram të bërë publik nga presidenca, është thënë se lidhjet e fuqishme në mes të Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara janë farkëtuar nga përkushtimi i përbashkët për bërjen e Kosovës vend sovran, të pavarur, multietnik dhe demokratik.

Presidenti Trump ka përgëzuar Kosovën edhe për zgjedhjet e mbajtura në muajin tetor. “I

nderuari President, populli amerikan dhe unë së bashku, urojmë të gjithë qytetarët e Kosovës për 12-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Lidhjet e fuqishme në mes të Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara janë farkëtuar nga përkushtimi i përbashkët për bërjen e Kosovës vend sovran, të pavarur, multietnik dhe demokratik. E përgëzojmë Kosovën për zgjedhjet demokratike në muajin tetor dhe mirëpresim angazhimin e vazhdueshëm për të çuar përpara paqen, drejtësinë dhe prosperitetin për popullin e Kosovës si dhe tërë rajonin e

Ballkanit Perëndimor. Ju dëshirojmë sukses në vitin që ka filluar në fokusimin tuaj në normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, në forcimin e sundimit të ligjit si dhe në krijimin e kushteve për zhvillim sa më vibrant të sektorit privat. E ardhmja e vendit tuaj është e ndritshme. Shtetet e Bashkuara

mbesin të përkushtuara për marrëdhënie të fuqishme bilaterale, të mbështetura në punën e veshme të popullatës tuaj dinamike dhe në përcaktimin e përhershëm për vlerat tona të përbashkëta”, thuhet në telegramin e presidentit Trump. Po ashtu, presidenti i

Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, ka uruar Thaçin për 12-vjetorin e pavarësisë.

“Kosovën dhe Gjermaninë i lidhin marrëdhëniet e mira afatgjate”, shkruan ndër të tjera presidenti Steinmeier në letrën e tij. Ai më tej ka shkruar se në këto dymbëdhjetë vjet të pavarësisë saj Kosova ka bërë një rrugë të gjatë, porse sipas tij, ajo edhe më tej ndodhet para detyrave të mëdha. “Krahas kësaj, qenësore për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor në përgjithësi është që të ketë progres në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë, e cila kontribuon në stabilitetin e të gjithë rajonit. Në këtë çështje Gjermania edhe në të ardhmen do të qëndrojë si partnere përkrah Kosovës”, thuhet në letrën e presidentit Frank-Walter Steinmeier.

## Rama shkon në Moskë më 26 shkurt, takon Lavrovin



PRISHTINË, 14 SHKURT - Agjencia shtetërore e lajmeve ruse TASS ka njoftuar të premten se kryeministri i Shqipërisë Edi Rama do të mbërrijë në Moskë më 26 shkurt.

Media citon burime nga Ambasada e Shqipërisë në Rusi, e cila thotë se vizita e Edi Ramës zhvillohet si pjesë e axhendës së Presidencës së radhës së OSBE që mbahet këtë vit nga

Shqipëria. Lidhur me axhendën e Ramës në kryeqytetin e Rusisë, TASS njofton se deri më sot është përcaktuar takimi me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergei Lavrov.

“Axhenda është duke u aprovuar”, citohet të kenë thënë për medien ruse burime nga Ambasada shqiptare në Moskë. Ditë më parë mediet kanë

njoftuar se në kuadër të kryesimit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama do të zhvillojë një vizitë në Rusi.

Në fjalimin e tij përpara Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, kryeministri Rama e listoi Ukrainën si një prej prioritetëve të presidencës shqiptare të OSBE-së.

## Konferenca e donatorëve ndërkombëtarë për Shqipërinë mbahet të hënën

TIRANË, 14 SHKURT - Bashkimi Evropian do të organizojë Konferencën e donatorëve ndërkombëtarë më 17 shkurt në Bruksel për mbështetjen e programit të rindërtimit në Shqipëri pas tërmetit që goditi vendin më 26 nëntor 2019. E organizuar nga Komisioni

Evropian, Konferenca do të mbledhë së bashku BE-në dhe vendet anëtare, partnerë nga Ballkani Perëndimor, përfaqësues të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile. Presidentja e Komisionit

Evropian Ursula von der Leyen do të hapë Konferencën së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, dhe presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel. Fjalimet hapëse do të pasohen së pari nga një prezan-

tim, që do paraqitet nga Komisionari evropian për menaxhimin e krizave, Janez Lenarçiq, lidhur me reagimin fillestar të emergjencës dhe për vlerësimin e nevojave të pas tërmetit, i përgatitur nga BE-ja, Kombet e Bashkuara, Banka Botërore dhe Qeveria e



Shqipërisë dhe që do të shërbejë si baza e programit të rindërtimit dhe rehabilitimit.

Analistët politikë komentojnë të arriturat dhe dështimet e shtetit të Kosovës në 12 vjetët e ekzistimit të tij

# Analistët: Edhe në 12-vjetorin e pavarësisë Kosova në pozitë jo të mirë



Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se Republikën e Kosovës 12-vjetori i shpalljes së pavarësisë po e gjen në pozitë jo të mirë. Behxhet Shala, Faton Abdullahu dhe Albinot Maloku kanë thënë për gazetën “Epoka e re” se rrugëtimi i Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë me plot sfida. Sipas tyre, në këtë përvjetor Kosova ka një qeveri të re, por shumë sfida politike, sociale dhe ekonomike. Teksa kanë numëruar të arriturat dhe ngecjet, ata kanë theksuar dështimet e Kosovës në planin e jashtëm

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Republika e Kosovës të hënën, më 17 shkurt, shënon 12-vjetorin e shpalljes së pavarësisë. Në vigjilje të mëvetësisë së Republikës, njohësit e rrethanave politike në vend kanë folur për sfidat me të cilat është përballur Kosova gjatë kësaj kohe, duke përmendur sukseset dhe dështimet. Ata kanë bërë me dije se ky 12-vjetor nuk po e gjen në pozitë të mirë shtetin e Kosovës. “Ky përvjetor po e gjen Kosovën në një situatë ku marrëveshja finale me Serbinë vetëm sa nuk ka përfunduar. Po e shihni se tani çdo ditë po arrihen marrëveshje në fusha të caktuara, ndërsa kur të shpenzohen këto marrëveshje, në fund do të thuhet se tashmë ka përfunduar çështja e marrëveshjes me Serbinë”, ka thënë për “Epokën e re” analisti politik Behxhet Shala.

Ai ka treguar se Kosova po përballet edhe me mungesë të perspektivës për qytetarët e saj. “Gjendja jo e mirë ekonomike po i nxitë qytetarët ta lëshojnë vendin. Të gjitha ata që nuk kanë ndonjë vend pune, apo edhe kanë një zant, kërkojnë rrugëdalje jashtë Kosovës. Kjo është një brengosje e madhe sepse tani Kosova po zbrazet nga të rinjtë

dhe po mbetet në duart e njerëzve të moshës së mesme apo të moshuar. Përkundër përpjekjeve për ta ndalur këtë proces, nuk po ia dalin, sepse ky është një proces që po ndodh edhe në vendet e rajonit. Pra, nuk është një proces i izoluar”, është shprehur ai.

Analisti tjetër politik Faton Abdullahu ka deklaruar për gazetën se që nga shpallja e pavarësisë Kosova asnjëherë nuk ka qenë më keq. “Që nga paslufta asnjëherë nuk kemi qenë më keq. Serbia nuk perceptohet si dikur agresive dhe planprishëse e paqes dhe sigurisë në rajon dhe ne nuk jemi unikë, ndërkaq zhvillimet gjeopolitike rajonale dhe më gjerë nuk janë sa kanë qenë dikur në favorin tonë. Për më keq aktualisht kemi një qeveri, kryeministri i së cilës është krejt i papërvojë, i cili ka humbur platformave në aeroportet evropiane dhe po vonon të jetë në kohë aty ku duhet të jetë dhe ku nënshkruhen marrëveshjet e rëndësishme nga ministrat e tij. Ky është rezultat i logjikshëm i determinuar nga një marrëveshje inekzistente ndërmjet dy subjekteve LV dhe LDK të cilat dolën fituese në zgjedhjet e fundit e të cilat nuk janë marrë vesh për shumë gjëra e më së paku se si do t’ia bëjnë me Serbinë”, ka thënë

Abdullahu. Sipas tij, këto dy subjekte politike gjatë gjithë fushatës kanë anashkaluar qëllimshëm dialogun me Serbinë. “Kjo qasje nuk është determinim i mungesës së njohurive dhe dijës së këtyre dy subjekteve. Jo. LV-ja dhe LDK-ja e kanë ditur se dialogu është tema e parë dhe më e rëndësishme me të cilën duhet të merren, por grykësia për ta marrë pushtetin i ka shtyrë që ta anashkalojnë dialogun sepse u është dukur temë jo populiste që nuk sjell vota e simpati. Krejt kjo ka qenë mashtrim që mund të na kushtojë shumë e i cili më pas do të kërkojë shumë kohë e mund që të riparohet”, është shprehur Abdullahu. Ndërsa analisti Albinot Maloku ka treguar për gazetën se rrugëtimi i shtetit të Kosovës gjatë këtyre 12 vjetëve nuk ishte i lehtë. “Republika e Kosovës këto 12 vjet prej kur ajo e shpalli pavarësinë nuk është se i pati të lehta e pa sfida, mirëpo ecejaket e saj nuk do të ndalen. Rrumbullakimi i shtetësisë së saj ndodh atëherë kur Kosova do të bëhet anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara”, ka deklaruar ai. Sipas tij, ky përvjetor e gjen Republikën e Kosovës me sfida të shumta. “Të arriturat e saj në rrafshin diplomatik, sidomos në vitet e para dhe pas shpalljes së pavarësisë, ishin shumë të mira. Më pastaj patë një regres.

Përvjetori i 12 Republikën e Kosovës e gjënë me qeveri të re, por me sfida shumë të mëdha, sidomos sociale dhe ekonomike”, ka vlerësuar Maloku.

## Kosova ngec në planin e jashtëm

Njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se gjatë kësaj periudhe kohore Kosova ka pasur të arritura, por edhe ngecje. Sipas tyre, dështimet më të mëdha të Kosovës kanë qenë në planin e jashtëm. Analisti Behxhet Shala ka vlerësuar se gabimi më i madh që ka ndodhur gjatë këtyre viteve ka qenë vendosja e njerëzve të padijshëm në pozita të rëndësishme. “Gabimi më i madh gjatë këtyre viteve në procesin e shtetndëritimit ka ndodhur se aty ku është dashur të vendosen njerëz me kompetencë të madhe, kanë shkuar njerëz të padijshëm dhe njerëz të cilët nuk e kanë dashur këtë vend. Pastaj, në planin e jashtëm Kosova ka pasur shumë ngecje gjatë kësaj periudhe. Së fundi, nuk ka pasur ndonjë njohje të rëndësishme apo ndonjë anëtarësim në ndonjë organizatë ndërkombëtare. Madje, së fundi, është aktivizuar procesi i çnjohjeve për të cilin më herët nuk kemi dëgjuar”, ka thënë Shala, duke

shtuar se të arriturat më të mëdha të Kosovës gjatë këtyre 12 vjetëve kanë qenë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e shkollave. Sipas tij, kanë munguar edhe investimet në projektet zhvillimore të cilat do të ndikonin në hapje të vendeve të punës.


Kurse analisti Faton Abdullahu ka vlerësuar se nëse dështimet dhe sukseset e shtetit të Kosovës në vitin e kaluar maten me atë se sa është përmirësuar kualiteti i jetës së qytetarëve atëherë, sipas tij, nuk ka ndodhur ndonjë përmirësim i madh. “Brenda këtij viti jo vetëm se kemi pasur çnjohje, por mungesën e çnjohjeve tashmë po e konsiderojmë si e arritur. Taksa ka dëmtuar bizneset dhe xhepin e qytetarit tonë, kurse ne kemi trumbetuar me rrahagjoks se e kemi dëmtuar deri në përlujtë Serbinë dhe i kemi mbrojtur kufijtë e Kosovës të cilët paskan dashur t’i ndryshojnë në dem tonin Thaçi, Rama dhe Vuçiqi”, ka vlerësuar ai, duke shtuar se spektri politik është dashur të jetë unik në procesin e dialogut ndaj Serbisë. “E keqja tjetër e cila nuk u riparua edhe atëherë kur Serbia me diplomacinë e saj agresive na dëmtonte pandalshëm ishte se asnjëherë nuk u bëmë unikë kundër saj dhe nuk dolëm me një qëndrim para miqve tanë ndërkombëtarë. Në anën tjetër, nëse dita e mirë shihet në mëngjes, atëherë mund të thuhet se Qeveria Kurti (LV-LDK), ende pa aguar dita, ka ngjallur neveri dhe zhgënjim me atë që ka bërë dhe atë që nuk ka bërë, për disa muaj në bisedat për ta krijuar qeverinë aktuale. Duhet të gëzohemi për 17 Shkurtin, me urimin që të këqijat si këto të zgjasin shkurt”, ka thënë ai.

E analisti Albinot Maloku ka treguar se një nga dështimet më të mëdha të Kosovës ka qenë mosanëtarësimi në Interpol. “Shteti i Kosovës patjetër që ka të arritura dhe ato janë të prekshme e të pakontestueshme, mirëpo edhe dështime të shumta. Dështim i pakontestueshëm i Kosovës është mosanëtarësimi në Interpol si dhe vazhdimi i mbetjes së shtetasve kosovarë në pamundësi për të lëvizur të lirë si shtetasit e vendeve të rajonit. Ajo çfarë kërkon urgjencë e të jetë edhe prioritet kryesor i qeverisë, e përmes së cilit do të matet puna e tyre, është zhvillimi ekonomik dhe hapja e perspektivës për qytetarët”, ka thënë Maloku.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, AKADEMIK REXHEP QOSJA

# KOSOVA, NJË SHTET

Akademik Rexhep Qosja në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, me rastin e 12-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ka thënë se Kosova është një shtet i hallakatur. Qosja ka thënë se e quan të tillë, sepse Kosova ende është pa themele të përcaktuara shtetërore. “Duke mos qenë shtet funksional, po i hallakatur, në Kosovën e sotme sundojnë individët e nuk qeverisin institucionet”, ka thënë ai, duke shtuar se në Kosovën e sotme as në ëndërr nuk shihet shteti i së drejtës. Qosja ka theksuar se institucionet e saj të pavarura janë të kapura prej institucioneve të quajtura shtetërore ligjvënëse dhe zbatimore (ekzekutive). Megjithatë, akademik Qosja thotë se me rëndësi të madhe, jetësore dhe historike për shqiptarët, është se Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. Dhe, sipas tij, me rëndësi jetësore dhe historike për shqiptarët është se kjo liri dhe pavarësi e saj është e mbrojtur, e mbrojtur dje e sot e të shpresojmë edhe nesër prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 13 SHKURT** - Me rastin e 12-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në këtë intervistë dhënë ekskluzivisht gazetës “Epoka e re”, ka folur akademik Rexhep Qosja. Ai ka thënë se me rëndësi të madhe, jetësore dhe historike për shqiptarët është se Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. “Dhe, me rëndësi jetësore dhe historike për shqiptarët është se kjo liri dhe pavarësi e saj është e mbrojtur, e mbrojtur dje e sot e të shpresojmë edhe nesër prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Them kështu sepse po mos të ishte kjo mbrojtje, me praninë edhe të njërive ushtarake të ShBA-së në Bonstill, kush e di se çka krejt do të mund të ndodhte me Kosovën dhe me popullin e saj shqiptar! Kush e di se çka krejt do t’i sillnin Kosovës Serbia dhe sponsorja historike dhe e përtashme e saj, Rusia. Në saje të kujdesit dhe mbrojtjes që gëzon prej ShBA-së, Kosova sot është e njohur prej 117 vendeve si shtet”, ka thënë akademik Qosja.

Ai ka theksuar se Kosovën sot, shtet a parashtet, nuk e shohin dhe nuk e trajtojnë njësoj të gjithë qytetarët e saj. Sipas Qosjes, për një numër të këtyre qytetarëve të saj, sidomos të atyre që e bëjnë politikën e saj, ajo është parajsë, që u ka sjellë shumë e shumë të mira, shumë e shumë pasuri të quajtura të paluajtshme, shumë e shumë miliona, shumë e shumë udhëtime politike turistike

anekënd botës e qejfe të tjera të ndryshme e të shumta! “Për një numër tjetër të qytetarëve të saj Kosova është shtet që i ka lënë në varfëri të skajshme, që i ka lënë të shpërfillur e të përbuzur, që i ka lënë të jetojnë me nga dy dollarë në ditë! Që i ka lënë të bëjnë çmos për të ikur në botën e huaj dhe ta kërkojnë fatin në strehimoret e saj!”, ka deklaruar Qosja.

Ai ka dhënë kritika për institucionet në fushën e drejtësisë, duke theksuar se institucionet e pavarura të shtetit tonë janë të kapura prej institucioneve të quajtura shtetërore ligjvënëse dhe zbatimore (ekzekutive). Akademik Qosja ka folur edhe për veten e për familjen e vet, në këtë dymbëdhjetëvjetor të Kosovës shtet. Ai ka thënë se ndaj tij Kosova që dymbëdhjetë vjet është parashtet i vrazhdë. “Mund të them se ndaj meje Kosova që dymbëdhjetë vjet është parashtet i vrazhdë. Gjatë dymbëdhjetë vjetëve të Kosovës së lirë e të pavarur unë kam hyrë vetëm dy herë në dy zyra të quajtura shtetërore: një herë në zyrën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, që atëherë ishte Jakup Krasniqi e herën tjetër në zyrën e kryeministrit të Kosovës, që atëherë ishte Agim Çeku. Dhe, kurrë më”, ka thënë ai.

Qosja flet edhe për dëbimin prej punës të vetmit fëmijë të tij në administratën shtetërore, e cila në moshën 57-vjeçare me dy nipa të tij u detyruan të bëhen edhe një herë azilant! “E tani që sa kohë, dy mbesave të mia, me fakultete të kryera, nepotistët e

shumëzuar ua mohojnë çdo mundësi për punësim për çka ato dhe kërkojnë mundësinë të bëhen azilante! Dhe, në qoftë se nepotistët e shumtë, që Kosovën e kanë bërë shtet fisnor parahistorik, në të vërtetë shtet familjar, ia caktojnë fatin e azilantit edhe nipit të tretë të Rexhep Qosjes që ende jeton në Prishtinë, çka i mbetet Rexhep Qosjes: të bëhet azilant edhe ai

në moshën 84-vjeçare! Po mirë, do të bëhet azilant!”, ka deklaruar Qosja.

Akademik Qosja ka folur edhe për koalicionin qeverisës LV-LDK. Ai ka thënë se Qeveria e re me Albin Kurtin kryeministër do të bëjë krejt ç’mund të bëjë për ta shëruar Kosovën prej sëmundjeve të ndryshme e të shumta politike, ekonomike, arsimore, gjyqësore korruptive

dhe nepotiste. Ai në këtë intervistë ka folur edhe për përplasjen Rama - Haradinaj.

**“Epoka e re”:** Z. Qosja, Republika e Kosovës shënon 12-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Cila është përshtypja juaj për këto dymbëdhjetë vjet shtet?

**Rexhep Qosja:** Me rëndësi të madhe, jetësore dhe historike

# I HALLAKATUR



Bonstill, kush e di se çka krejt do të mund të ndodhte me Kosovën dhe me popullin e saj shqiptar! Kush e di se çka krejt do t'i sillnin Kosovës Serbia dhe sponsorja historike dhe e përtashme e saj, Rusia. Në saje të kujdesit dhe mbrojtjes që gëzon prej ShBA-së, Kosova sot është e njohur prej 117 vendeve si shtet.

Por, Kosovën sot, shtet a parashtet, nuk e shohin dhe nuk e trajtojnë njësoj të gjithë qytetarët e saj. Për një numër të këtyre qytetarëve të saj, sidomos të atyre që e bëjnë politikën e saj, ajo është parajsë, që u ka sjellë shumë e shumë të mira, shumë e shumë pasuri të quajtura të paluajtshme, shumë e shumë miliona, shumë e shumë udhëtime politike turistike anekënd botës e qejfe të tjera të ndryshme e të shumta!

Për një numër tjetër të qytetarëve të saj Kosova është shtet që i ka lënë në varfëri të skajshme, që i ka lënë të shpërfillur e të përbuzur, që i ka lënë të jetojnë me nga dy dollarë në ditë! Që i ka lënë të bëjnë çmos për të ikur në botën e huaj dhe ta kërkojnë fatin në strehimoret e saj!

Për disa të tjerë, që e quajnë vetën intelektualë, disa prej të cilëve nuk jetojnë edhe aq keq e disa prej të cilëve jetojnë kurrqysh, Kosova është një shtet i hallakatur. E quajmë të tillë, sepse ajo, Kosova, ende është pa themele të përcaktuara shtetërore, ende nuk dihet është shtet i të ashtuquajturës gjedhe liberale apo shtet i të ashtuquajturës gjedhe sociale. Kosova ende nuk ka sistem të vlerave. Kosova në shoqërinë e saj në vend të parë vë jo qytetarin, po partiakun.

Në Kosovën e sotme as në ëndërr nuk shihet shteti i së drejtës. Institucionet e saj të pavarura janë të kapura prej institucioneve të quajtura shtetërore ligjvënëse dhe zbatimore (ekzekutive).

Duke mos qenë shtet funksional po i hallakatur, në Kosovën e sotme sundojnë individët e nuk qeverisin institucionet.

Në vend të qëndrueshmërisë (stabilitetit) në Kosovë, prandaj, përsëriten krizat kur më të shkurtra e më shpesh më të gjata. Nuk u shpreha saktë: Kosova në të vërtetë është në krizë institucionale të përhershme, që demagogët në Kosovë e në Shqipëri e quajnë tranzicion!

E çka mund të them unë vetë, për veten e për familjen time, në

këtë dymbëdhjetë vjetor të Kosovës shtet?

Mund të them se ndaj meje Kosova që dymbëdhjetë vjet është parashtet i vrazhdë. Gjatë dymbëdhjetë vjetëve të Kosovës së lirë e të pavarur unë kam hyrë vetëm dy herë në dy zyra të quajtura shtetërore: një herë në zyrën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, që atëherë ishte Jakup Krasniqi e herën tjetër në zyrën e kryeministrit të Kosovës, që atëherë ishte Agim Çeku. Dhe, kurrë më.

Në qoftë se lëmë anash financimin e botimit të kompletit të veprave të mia, më në fund si edhe të completeve të akademikëve të tjerë dhe të autorëve të tjerë, për të cilët është kërkuar ai financim, unë mund të them se Kosova e këtyrë siç ishte e sunduar deri sot është sjellë jo vetëm me shpërfillje, por edhe me mosdurim ndaj meje. Është bërë e çka s'është bërë për t'u shpërblyer me shpërfillje, me ndëshkim puna ime me shkrime dhe me politikë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës në vitet kur të tjerët i këndonin bashkim-vëllazërimin, autonomisë së Kosovës dhe socializmit vetëqeverisës të Jugosllavisë, kurse shkrimet e mia të tilla mund të botoheshin kryesisht në Kroaci e në Slloveni. Shkrimet e mia, pas demonstratave të rinisë sonë studentore dhe shkollore në vitin 1981, me të cilat mbrohej Kosova, me të cilat mbroheshin historia, tradita, kultura, letërsia popullore, vlerat etike të shqiptarëve prej shovinizmit serb, një kohë edhe maqedonas e malazez, shkrimet e mia në të cilat shqiptarët quheshin popull i tretë për nga numri në Jugosllavi e jo pakicë kombëtare, në të cilat shqiptarët quheshin popull që i takon e drejta e vetëvendosjes, e drejta për ta caktuar vetëm fatin e vet dhe quheshin ashtu kur në Prishtinë, pas rënies së komunizmit, krijoheshin partitë tona të para, që regjistroheshin në Ministrinë Republikane të Serbisë në Beograd dhe në programet e tyre kërkonin autonominë për Kosovën - gjithë ato shkrime u shpërblyen me ndëshkime të familjarëve të mi.

Ashtu me ndëshkime të familjarëve u shpërblyen edhe veprat e mia të tjera publicistike siç janë: "Populli i ndaluar" (1990), "Strategjia e bashkimit shqiptar" (1992), "Çështja shqiptare - historia e politika" (1994), "Fjalor demokratik" (1997), "Ligjërime paravajtëse"

(1996), në të cilat i shpjegohej opinionit jugosllav e botëror e gjithë dhuna e i gjithë terrori që ushtronte Serbia e Millosheviqit e kishin ushtruar edhe Serbia e para Millosheviqit ndaj shqiptarëve.

Jeta ime kushtuar gjithë këtyre veprave me të cilat mbrohej liria dhe pavarësia e Kosovës, mbrohej historia, e kultura, dinjiteti shqiptar; mandej qindra e qindra takime të miat me politikanë, diplomatë e delegacione amerikane e evropiane që vinin në Kosovë për t'u njohur me gjendjen në Kosovë nën dhunën e terrorin e Serbisë, pjesëmarrja ime në Konferencën e Rambujesë, shumë e shumë faqe të shkruara e shumë e shumë paraqitje të mia në mbrojtje të UÇK-së prej atyre që e sulmonin, zhvlerësonin dhe mohonin luftën e saj të gjykuar thoshin të dështojë, u shpërblyen e si u shpërblyen: me dëbimin prej punës të vetmit fëmijë timin në administratën shtetërore, e cila në moshën 57-vjeçare me dy nipa të mi u detyruan të bëhen edhe njëherë azilantë! E tani që sa kohë, dy mbesave të mia, me fakultete të kryera, nepotistët e shumëzuar ua mohojnë çdo mundësi për punësim për çka ato dhe kërkojnë mundësinë të bëhen azilantë! Dhe, në qoftë se nepotistët e shumtë, që Kosovën e kanë bërë shtet fisnor parahistorik, në të vërtetë shtet familjar, ia caktojnë fatin e azilantit edhe nipit të tretë të Rexhep Qosjes që ende jeton në Prishtinë, çka i mbetet Rexhep Qosjes: të bëhet azilant edhe ai në moshën 84-vjeçare! Po mirë, do të bëhet azilant!

Ky do të jetë shpërblimi i fundit e më i madhi që do të ma dhurojë Kosova e atyre që e bënë shtet të tyre privat për të ato që kam bërë unë për të - për Kosovën e dinjitetive, të të drejtave e të gjasave ligjore të barabarta!

Po, të them, gjithë kjo sjellje mospërfillëse, ndëshkuese e zezë ndaj meje për gjithë ato që bëra për Kosovën e lirë e të pavarur e të bashkuar një ditë me Shqipërinë, nuk më çudit: ata që më ndëshkuan kështu mua, ashtu me të zeza i shpërblyen edhe 28 vjet burgje serbe të Adem Demaçit! Nuk i lejuan të bëhet kryetar i Kosovës, as kryeministër i Kosovës, as ministër i Kosovës, as, madje, i kandiduar për deputet të Kosovës!

Ata, që as Adem Demaçin që gjatë 28 vjetëve burgje serbe i kishte mësuar shumë për

politikën e Serbisë ndaj popullit shqiptar e as mua që kisha shkruar gjithë ato faqe e vepra për politikën mbi njëqindvjeçare shoviniste serbe ndaj popullit shqiptar, nuk u quajtën të arsyeshme që sundimtarët e Kosovës të na takojnë e të pyesin se çka e si i mendojmë bisedimet e sotme me Serbinë. Por, këta shpërfillës, mohues e ofendues të Adem Demaçit, sot i shkojnë Adem Demaçit te varri dhe me nëntë hipokrizi të ndryshme i bëjnë gjoja nderime!

Po mirë, mirë, të gjitha këto një ditë do të bëhen libra, shpjegime historike, filma që do t'i duhen popullit shqiptar për t'u mbrojtur prej dhunëtarëve partiakë e politikë në kohën që do të vijë.

**"Epoka e re":** Në këtë 12-vjetor, Republika e Kosovës, si rezultat i zgjedhjeve të 6 tetorit, ka një koalicion qeverisës me kryeministër Albin Kurtin. Ju edhe keni bërë një thirrje publike që Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës të bashkohen për një qeveri të përbashkët. Kjo do të thotë se ju prisni një qeverisje më të mirë nga këto parti se qeveria e kaluar?

**Rexhep Qosja:** Jo vetëm unë, dhe jo vetëm ata që votuan në ndryshimet, me kryeministër Albin Kurtin, po sigurt numri më i madh i qytetarëve të Kosovës shpreson se Qeveria tani e krijuar do të bëjë krejt ç'mund të bëjë për ta shëruar Kosovën prej sëmundjeve të ndryshme e të shumta politike, ekonomike, arsimore, gjyqësore, korruptive, nepotiste e të tjera e të tjera që ia shkaktoi pushteti i derisotëm. Mbetet të shihet.

**"Epoka e re":** Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri duket se është thyer pas përplasjeve që patën z. Rama dhe z. Haradinaj. A ka rrezik që të ftohen raportet Kosovë - Shqipëri apo si mund të ndreqen ato?

**Rexhep Qosja:** Ajo mund të jetë ftohje fare e shkurtër e marrëdhënieve mes individëve politikë e jo e marrëdhënieve shtetërore në përgjithësi. Forcat shqiptare që ruajnë lidhjet, kohezionin social, shpirtëror e kombëtar mes shqiptarëve janë shumë më të shumta se disa forca të skajshme që kanë dalë në skenën politike me ide që e rrezikojnë atë kohezion. Dy emrat e përmendur nuk i shoh ndër ata që e rrezikojnë atë kohezion.

për shqiptarët është se Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. Dhe, me rëndësi jetësore dhe historike për shqiptarët është se kjo liri dhe pavarësi e saj është e mbrojtur, e mbrojtur dje e sot e të shpresojmë edhe nesër prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Them kështu sepse mos të ishte kjo mbrojtje, me praninë edhe të njëjësive ushtarake të ShBA-së në

# Lansohet analiza e pulsit publik për pajtimin dhe bashkëjetesën

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 SHKURT - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka lansuar të premten analizën e pulsit publik për pajtimin dhe bashkëjetesën që eksploron perceptimin e njerëzve për procesin e pajtimit ndëretnik në Kosovë, problemet, sfidat dhe mundësitë duke synuar të zbulojë se si, nga këndvështrimi i qytetarëve, institucionet e Kosovës, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare mund ta mbështesin më së miri pajtimin në Kosovë.

Për qëllimet e këtij studimi janë anketuar 451 respondentë kosovarë si dhe janë mbajtur 12 grupe të fokusit të realizuara në shtatë komuna multietnike, përkatesisht në Prizren, Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Kamenicë, Shtërpcë, Graçanicë, dhe Istog.

Anketa dhe fokus grupet janë realizuar gjatë muajve qershor-korrik 2019. "Me rritjen e ndërveprimeve të përditshme në një mjedis multietnik, rritet edhe niveli i të jetuarit më rehatshëm me etnitë e tjera. Ne duhet të punojmë për të siguruar mundësi që njerëzit nga etni të ndryshme të bëhen bashkë për t'i adresuar sfidat e përbashkëta dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta, kurse dallimet e tyre t'i konsiderojnë përfitim dhe jo pengesë", ka pohuar Christina T. Davis, drejtoreshë në Zyrën për Demokraci dhe Qeverisje në USAID në Kosovë.

Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, ka thënë



se gjatë 17 vjetëve të fundit, në partneritet me USAID-in, kanë mbledhur të dhëna dhe informacione të cilat kanë ofruar një pasqyrë më të thellë, duke filluar nga perceptimet për demokratizimin, ekonominë, drejtimin politik dhe sigurinë e deri tek komunitetet e ndryshme etnike në Kosovë. "Një pikënisje e rëndësishme kur punohet për ndërtimin e besimit dhe kohezionit social midis komuniteteve është që të shikohet se si ata bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. Ne e kemi përdorur këtë koncept përmes projektit 'Dialogu ndërmjet komuniteteve përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë kulturore', i mbështetur nga BE-ja, i cili synon t'i thyjë barrierat mes komuniteteve përmes interesave të përbashkëta", ka deklaruar Suokko.

## TË GJETURAT KYÇE NGA ANALIZA

- Përfshirja e komunitetit ndërkombëtar u konsiderua shumë e rëndësishme nga 47 për qind dhe si deri-diku e rëndësishme nga 31 për qind e të anketuarve. Për më tepër, pjesëmarrësit në disa grupe të fokusit e përshkruan rëndësinë e komunitetit ndërkombëtar si lehtësues të procesit të pajtimit.

- Shumica e të anketuarve në komunën e Graçanicës (92 për qind) dhe të Mitrovicës së Veriut (73 për qind) pretenduan se ishin deri-diku rehat ose shumë jorehat që jetojnë në një mjedis multietnik. Për më tepër, shumica e të anketuarve nga

Mitrovica e Veriut besojnë se pajtimi nuk është i nevojshëm (60 për qind).

- Edhe pse grupet etnike ndryshojnë në të kuptuarit e tyre të konceptit të pajtimit, ata të gjithë pajtohen se ndëshkimi i atyre që kanë kryer krime gjatë ndërtimit i marrëdhënieve të mira ndëretnike janë thelbësore për arritjen e pajtimit në Kosovë. Për më tepër, pjesëmarrësit në grupet e fokusit besojnë se ka shumë 'plagë të hapura' nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999, të cilat duhet të trajtohen përpara se të arrihet pajtimi. Shqiptarët e Kosovës thanë edhe se çështja e personave të zhdukur nga konflikti i viteve 1998-1999 është pengesë e rëndësishme në këtë drejtim.

- Pothuajse gjysma e të

anketuarve janë të pakënaqur me punën e institucioneve publike të Kosovës në lidhje me promovimin e pajtimit. Përveç kësaj, të anketuarit kryesisht besojnë se institucionet publike të Kosovës nuk kanë bërë sa duhet për t'i mbështetur viktimat që përjetuan abuzime të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999.

- Siguria publike është çështje shqetësuese për 46 për qind të serbëve të Kosovës që pretendojnë se ndihen të paktën deri-diku të pasigurt në rrugë. Ekziston një lidhje e fortë pozitive në mes të nivelit të ndjenjës së sigurisë në rrugë të të anketuarve dhe këndvështrimit të tyre për mundësinë e pajtimit.

- Gjatë diskutimeve në grupet e fokusit, serbët e Kosovës thanë se shqiptarët e Kosovës nuk duan të pajtohen, kurse shqiptarët e Kosovës thanë se janë serbët e Kosovës ata që nuk duan pajtim. Sidoqoftë, gjetjet e anketës zbuluan se shumica e pjesëtarëve të të dy etnive e mbështesin pajtimin ndëretnik në Kosovë.

- Në komunën e Shtërpcës serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës thanë se komuna dhe OJQ-të duhet të punojnë së bashku për të hartuar programe dhe aktivitete, si mjete për lehtësimin e pajtimit që i bashkojnë banorët lokalë shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës. Për më tepër, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit të të gjitha prejardhjeve përmendën si pengesë dallimet kulturore, përfshirë edhe pengesën gjuhësore.

## UP-ja promovon monografinë me rrëfime të studentëve, krenar me kontributin 50-vjeçar



PRISHTINË, 14 SHKURT - Universiteti i Prishtinës (UP) ka promovuar librin "50 vjet Universiteti i Prishtinës". Rektori i UP-së, Marjan Dema, ka pohuar se UP-ja është një institucion i rëndësishëm i arsimit të lartë. Dema ka theksuar se në këtë 50-vjetor UP-ja është krenare për realizimin e misionit të saj. "Ju uroj 50-vjetorin e themelimit të UP-së, që është instituti më i rëndësishëm e me traditë i

arsimit të lartë. UP-ja ka kontribute domethënëse. Në 50-vjetor UP-ja është krenare për realizimin e misionit të vet. Studentët kanë bërë kthesat e historisë. Kjo histori e pasur e tempullit të dijes është e përfshirë në librin që promovohet në vazhden e aktiviteteve. Libri i sotëm, me rrëfime të studentëve, ofron një mozaik të historisë së UP-së", ka thënë rektori Dema.

Sali Bashota foli në emër të

autorëve dhe tha se botimi i monografisë është një ngjarje shumë e rëndësishme. "Botimi i një libri historik, siç është monografia, është një ngjarje e veçantë gjysmëshekullore, sepse ka vizionin e mija studentëve e profesorëve që dijen e tyre e zhvilluan në interes të qytetarëve", ka thënë Bashota. Në promovim të këtij libri ka folur edhe Faton Berisha, prorektor për shkencë dhe një nga redaktorët e librit.

## Ministrja Bajrami priti zëvendësministrin e sapoemëruar të Arsimit, Jusuf Thaçi

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka pritur të premten zëvendësministrin e sapo-

emëruar, Jusuf Thaçi, me të cilin ka biseduar për gjendjen në arsim dhe mundësitë për ta përmirësuar këtë gjendje në të gjitha nivelet e arsimit, por edhe në shkencë,

teknologji dhe inovacion. Ministrja Bajrami dhe zëvendësministri Thaçi diskutuan për programin e Qeverisë së Kosovës, ku arsimi zë vend të rëndësishëm

dhe u zotuan se do të punojnë së bashku për realizimin e këtij programi, i cili synon ofrimin e një arsimit më cilësor për fëmijët dhe të rinjtë në Kosovë.



Flet shkruesi i Deklaratës së Pavarësisë, Shyqri Nimani

# 16 orë rresht punova në Deklaratën e Pavarësisë

Nga mbrëmja e 16 shkurtit 2008, Shyqri Nimani, profesor i Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës, kaligrafisti i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, ka treguar shumë gjëra interesante. Ai për 16 orë rresht kishte punuar në Deklaratën e Pavarësisë, por që nga ajo kohë, tashmë ku po bën 12 vjet, askush nga qeveria nuk e ka ftuar për nënshkrimin e kontratës për punën që ka bërë. “Sidoqoftë, tani e përgjithmonë, deri në pagesën e honorarit, Deklarata mbetet pronë e imja artistike dhe historike”, ka thënë Nimani për gazetën “Epoka e re”. Në këtë intervistë, ai ka folur edhe për emocionet gjatë shkrimit të tekstit të Deklaratës së Pavarësisë në formatin A/4

**EPOKA E RE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT -

“Epoka e re”: Z. Nimani, Kosova më 17 shkurt feston 12-vjetorin e shpalljes së pavarësisë, ju për 16 orë rresht kishit punuar në Deklaratën e Pavarësisë dhe e kishit përfunduar pesëmbëdhjetë minuta para orës 15:00. Na tregoni rreth atyre çasteve.

**Nimani:** Ç’është e vërteta, në ato çaste unë kam pasur dy lloj ndjenjash të gërshetuara njëra me tjetrën, emocione dhe ankthe. Natyrisht se emocionet kishin të bënin me të qenit i vetëdijshëm se po ndodhte, më në fund, ajo ngjarje historike e shumëpritur e shqiptarëve dhe se fati kishte vendosur që unë ta kaligrafoja (bukurshkruaja) artistikisht me dorën time këtë akt të rëndësishëm së parë. Nga ana tjetër, ishte ankthi i madh që më kaploi kur kuptova atë mbrëmje se ishin tri faqe të plota të tekstit të Deklaratës në formatin A/4, të cilat unë do të duhej t’i kaligrafoja në pergamenë (lëkurë viçi). Paraprakisht unë u kisha thënë se do të më duheshin së paku shtatë ditë për këtë ndërmarrje të ndërlikuar, gjithë një duke menduar se teksti do të përmbante vetëm një faqe kompjuterike, A/4. I gjendur në këto rrethana të pavolitshme, unë nuk kisha zgjidhje tjetër pos t’i përvishesha punës me të gjitha fuqitë e mia të mundshme. Unë kisha marrë me vete të gjitha veglat dhe materialet e domosdoshme në zyrat e Qeverisë (meqë kështu më kishin kërkuar). Për çdo rast, kisha marrë me vete dy fletë të mëdha pergamene të formatit A/2 (420 x 594 mm). Kjo u tregua e arsyeshme sepse, pos tekstit shumë të gjatë të Deklaratës, duhej të llogaritej hapësira edhe për 120 nënshkrimet e kuvendarëve të Kuvendit (morën pjesë 109 gjithsej) si dhe për nënshkrimet e kryeministrit, presidentit dhe të kryetarit të Kuvendit.

Edhe pse, për një çast, kur koha e dorëzimit të Deklaratës po afrohej pamëshirshëm - mendova se nuk do t’ia dilja, se për herë të parë në jetën time artistike do të dështoja, por ishte djali im, Agoni, (i cili tërë kohën e 16 orëve ishte me mua dhe fotografonte kohë pas kohe), i cili më fuqizoi me fjalët e tij inkurajuese se ‘do t’ia dalësh’. Dhe



vërtet ia dola. Pastaj, të kënaqur, morën Deklaratën dhe nxituan për në Ndërtësen e Kuvendit të Kosovës, e cila, fatmirësisht, ishte fare pranë godinës së Qeverisë së Kosovës.

“Epoka e re”: Kryeministri i atëhershëm, z. Thaçi, erdhi dhe jua mori dokumentin. Çfarë ju tha në ato çaste, cili ishte komenti i tij i parë?

**Nimani:** Duhet të theksoj se kryeministri i atëhershëm, z. Hashim Thaçi, që nga fillimi i përgatitjeve dhe konsultimeve tregoi interesim të jashtëzakonshëm. Ai vinte kohë pas kohe gjatë procesit të kaligrafimit dhe shikonte me vëmendje shumë të përqendruar. Me të vinin edhe disa bashkëpunëtorë të tij, si Hajredin Kuçi, Vlora Çitaku... andaj, kur ai erdhi me një grup të vet dhe me gazetarin Blendi Fevziu, së bashku me kameramanin e TV KLAN të Tiranës, unë sapo isha duke e përfunduar kaligrafimin; ishin pikërisht 15 minuta para orës 15.00 të pasdites së 17 shkurtit të vitit 2008. Kur e panë të gjithë Deklaratën e kaligrafuar të përfunduar, ata shfaqën në fytyrat e veta befasinë admiruese.

“Epoka e re”: Është bërë e tëra fund e krye siç e kishit paramenduar, apo ju ngeli edhe diçka tjetër merak në punën tuaj për Deklaratën e Pavarësisë?

**Nimani:** Kufizimi drastik i imponuar nga afati kohor dhe nga papërvoja e punëdhënësit institucional në rastin e kaligrafimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, sigurisht se më ka penguar për realizimin e detyrës sipas paramendimit tim, që do të thotë sipas kanoneve të përcaktuara tradicionalisht. Unë kam dashur ta kaligrafoj Deklaratën me një font më të veçantë shkronjash, me inicialet ornamentale, me iluminacione shembëllesash florale dhe faunale, me ngjyra të llojeve nga më të ndryshmet dhe me zburimet e toneve të pigmenteve fluorocente si dhe me ngjyra bronzi të argjendta dhe të arta. Por, kam qenë i detyruar ta konvertoj konceptin paraprak, mbase ta quaj ‘pispillosës’, në atë më të ‘reduktuar’ - me përdorimin e vetëm një ngjyre, të së zezës dominuese, me shkronja të përmbajtura dhe më të lexueshme të stilit italic - me ritëm dhe dinamikë subtile. Sepse m’u kujtua dhe vendosa ta ndërlihdja

me tipin e shkronjave italic me të cilin është kaligrafuar dokumenti ynë i lashtë dhe i mirënjohur ‘Formula e pagëzimit’ (1462) nga kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli. Megjithatë, më vjen shumë mirë që edhe dokumenti i shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (4 korrik 1776) është kaligrafuar thjesht dhe vetëm me një ngjyrë dhe i përngjan dukshëm dokumentit tonë.

“Epoka e re”: Çfarë s’është thënë deri më tani rreth punës së kësaj deklarate?

**Nimani:** Mbase ka dhe shumë gjëra të tjera që nuk i kam thënë deri më tani. Një nga to është çështja e kontratës së autorësisë dhe e pagesës së honorarit. Mbrëmjen e 16 shkurtit 2008, kur unë isha duke u përgatitur ta bukurshkruaja Deklaratën në godinën e Qeverisë, më takoi Abedin Qupevaj, shef i protokollit, i cili më kërkoi që në kontratën që do ta bënim të figuronte që, pos meje, edhe Qeveria e Kosovës të ishte bashkautore e Deklaratës. Unë i thashë se për këtë çështje as që mund të mendoja, ngase unë po mendoja vetëm për mundësinë e kryerjes së

kaligrafimit në këto rrethana të vështira. Nga ajo kohë e deri më tani, tashmë mbi dhjetë vjet të kaluara, askush nga Qeveria nuk më ka ftuar për nënshkrimin e kontratës e as unë nuk kam vajtur atje. Sidoqoftë, tani e përgjithmonë, deri në pagesën e honorarit, Deklarata mbetet pronë e imja artistike dhe historike.

“Epoka e re”: Si ndiheshit ju derisa lexohej deklarata në seancën solemne dhe si ndiheni tani, kur jeni autor i dokumentit më historik të Kosovës?

**Nimani:** Kur e morën Deklaratën e kaligrafuar unë u ndjeva aq i çliruar, sa më dukej se hoqa nga vetja atë barrën e madhe të Sizifit nga trupi. Meqë unë dhe biri im, Agoni, ishim shumë të rraskapitur pas një pune të pandërprerë 16-orëshe dhe pa rroba solemne, aktin solemn të shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës e përjetuam me anë të ekranit televiziv në një nga hapësirat e Qeverisë. Përjetimi i atëhershëm ishte i papërshkrueshëm - lumturi ngashënjuese, marramendëse. E sot, fatkeqësisht, ai entuziazëm dhe magjepsje paksa (apo bukur shumë) është venitur. Por, prapëseprapë, pas shiut lind dielli.



# Kosova dhe Serbia nënshkruajnë marrëveshje për hekurudha dhe autostrada

Në Munih të Gjermanisë është nënshkruar marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë për hekurudha dhe autostrada që lidhin dy vendet. Marrëveshja për hekurudha dhe autostrada u arrit me ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan në Gjermani, Richard Grenell, i cili është edhe i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, edhe presidenti Thaçi dhe Vuçiq ishin pajtuar se fokusi i bisedimeve duhet të jetë në çështjet e zhvillimit ekonomik

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 13 SHKURT** - Delegacionet nga Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar të premtën, në Munih të Gjermanisë, dy letra të shprehjes së interesit, atë për hekurudha dhe atë për hekurudha, përmes të cilave të dy vendet shprehin

gatishmërinë për hapjen e rrugëve ekzistuese, por edhe për ndërtimin e rrugëve të reja që lidhin dy shtetet me rajonin dhe me BE-në.

Nënshkrimi i letrave të interesit ndodhi para fillimit të Konferencës së Sigurisë në Munih. Marrëveshja për hekurudha dhe autostrada u arrit me ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan në

Gjermani, Richard Grenell, i cili është edhe i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Në ceremoninë e nënshkrimit kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, si dhe ambasadori Richard Grenell. Për palën kosovare

letrat e interesit, përkatësisht marrëveshjet i kanë nënshkruar Xhemë Veseli, drejtor i Transportit Rrugor dhe Ramë Qupeva, drejtor i Infrastrukturës Rrugore. Kurse nga pala serbe, të dy marrëveshjet i ka nënshkruar drejtori i të ashtuquajturës Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq.

Ambasadori Grenell ka thënë se pas negociatave dhe marrëveshjes për linjën ajrore tani u arrit të negociohet edhe çështja e transportit hekurudhor dhe rrugor. "Ajo që kemi bërë sot është që kemi negociuar për ta hapim linjën hekurudhore dhe autostradat. Ne kemi negociuar për hapjen e linjës ajrore për fluturime

direkte mes Prishtinës dhe Beogradit dhe tani kemi edhe dy marrëveshje të tjera. Tani kemi dy marrëveshje më shumë dhe ajo që unë kam biseduar me të dy presidentët është që të përqendrohemi sa më shumë në zhvillimin ekonomik", ka deklaruar ambasadori amerikan. Sipas tij, edhe presidentët Thaçi e Vuçiq janë pajtuar që fokusi i bisedimeve duhet të jetë në çështjet e zhvillimit ekonomik. Ai ka theksuar se kur e kishte marrë misionin nga presidenti Donald Trump për ndërmjetësim në dialogun Kosovë - Serbi ishte frymëzuar pikërisht nga zhvillimi i fuqishëm ekonomik që kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, andaj edhe në këtë





ekonomik, progres, vende të punës, pra ajo çka u duhet njerëzve tanë në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Kosova beson në lidhshmërinë e presidentit Trump dhe administratën që gjatë gjithë kësaj periudhe dhe viti po punojnë për marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi. Kjo është rruga që duhet të ndjekim në të ardhmen dhe të mos mbetemi peng i të kaluarës së hidhur mes vendeve dhe popujve tanë”, ka theksuar presidenti i Kosovës. Thaçi ka shkruar edhe në llogarinë e vet në “Twitter” dhe ka falënderuar Shtetet e Bashkuara dhe ambasadorin Grenell për marrëveshjet. “Një tjetër moment historik! Së pari, marrëveshja për trafikun ajror, kurse sot kemi nënshkruar marrëveshjen për hekurudhat dhe autostradat. Faleminderit për vendosmërinë! Një hap i shkëlqyeshëm drejt arritjes së një marrëveshje përfundimtare paqeje midis dy vendeve”, ka shkruar Thaçi.

Në anën tjetër, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se bisedimet nuk ishin të lehta, por në fund, theksoi ai, u arritën marrëveshje të rëndësishme. Edhe Vuçiqi falënderoi presidentin Trump dhe të dërguarin e tij Grenell që po tregojnë interes të madh për rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Ajo që është nënshkruar është domethënëse për shkak të lirisë së lëvizjes, lëvizjes së mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve”, është shprehur Vuçiq, duke besuar se marrëveshja do të jetë një lehtësim për serbët që jetojnë në Kosovë, sidomos ata në pjesët qendrore e lindore të Kosovës.

Paraprakisht, po nën ndërmjetësimin e ambasadorit Grenell, të dy shtetet kanë nënshkruar edhe marrëveshjen për vendosjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd.

### Oda Ekonomike Amerikane mirëpret marrëveshjen për hekurudha dhe për autostradën

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mirëpritur nënshkrimin e marrëveshjes për hekurudhën dhe autostradën mes autoriteteve të Kosovës dhe asaj serbe. Oda Amerikane beson fuqishëm se

kjo marrëveshje do të sjellë përfitime të shtuara ekonomike për të dy vendet, sidomos për kompanitë e sektorit privat që operojnë në secilin vend. “Njohja reciproke, tregtia pa barriera dhe fuqizimi i lidhjeve ekonomike vetëm se do ta përmirësojnë perceptimin për të dy vendet në sytë e investitorëve amerikanë dhe të tjerë të huaj. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë thekson se çdo marrëveshje që lejon integrim ekonomik të rajonit e hap potencialin e të gjitha vendeve për rritje të përsheptuar ekonomike”, është theksuar në njoftimin për media të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

### OVLUÇK-ja kërkon sqarim nga Qeveria se çfarë përmbajnë marrëveshjet e arritura në mes të Kosovës e Serbisë

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka reaguar në lidhje me dy marrëveshjet e arritura në Muni, atë për hekurudhat dhe për autostradat mes Kosovës dhe Serbisë. “OVLUÇK-ja përshëndet çdo kontribut nga shtetet aleate dhe organizmat ndërkombëtarë që e mbështesin rumbullakimin e shtetndërtimit të Kosovës. Do të dëshironim të themi kështu edhe për dy angazhimet e

fundit në relacionin Kosovë - Serbi të personaliteteve të respektuara, z. Grenell, i ngarkuari i presidentit të ShBA-së, z. Trump dhe z. Borel, përfaqësuesi i lartë i BE-së. Nënshkrimi i marrëveshjes për korridorin ajror në relacionin Prishtinë - Beograd, po ashtu nënshkrimi i marrëveshjeve të sotme për hekurudhat dhe autostradat, siç e kemi parë në media, duken të mjegulluara. Prandaj, OVLUÇK-ja kërkon nga ish-Qeveria dhe Qeveria aktuale e Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e partitë politike, që ta sqarojnë publikun se çfarë përmbajnë këto marrëveshje”, është thënë në reagim e OVLUÇK-së.

## OEAK-u: Fuqizimi ekonomik i grave, tejet i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Nuk mund të ketë fuqizim të grave dhe vajzave nëse kjo nuk shndërrohet në kauzë të përgjithshme sociale për të cilën angazhohen fuqishëm edhe gratë edhe burrat. Kjo u tha të premten në një tryezë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Vjosa Osmani, kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjatë këtij takimi theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes më të madhe të grave në insti-

tucionet kyçe të Kosovës, duke shtuar se tani është koha e duhur që ato ta ngrehin zërin e tyre për të kontribuar për zgjidhjen e problemeve më akute me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat. Ajo inkurajoi gratë e suksesshme ndërmarrëse që suksesin e tyre ta shfrytëzojnë duke e shpërndarë modelin dhe të arriturat e tyre për t'i inspiruar dhe inkurajuar të tjerat. Sipas Osmanit, pabarazitë dhe sfidat gjinore janë ende shumë të mëdha në secilin pro-

fesion, duke theksuar më tej nevojën e fuqizimit ekonomik të grave, e sidomos të atyre që jetojnë në vende rurale.

Pjesë e panelit të këtij diskutimi ishin edhe Kujtesa Nezaj Shehu, udhëheqëse e Zyrës në SDP Kosovë; Brikena Avdyli, drejtoreshë ekzekutive në Jahjaga Foundation; Merita Limani, menaxhere e projektit në Këshillin Evropian, dhe Syzane Aliu, pronare e Magic Ice, të cilat ndanë përvojat e tyre personale të rrugëtimit në biznes dhe të zhvillimit profesional.



## Suspendohen nga puna dy inspektorë tatimorë

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se, bazuar në informatat e pranuar nga organet kompetente dhe duke u mbështetur në nenin 69 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ka marrë vendim

mbi pezullimin parandalues nga marrëdhënia e punës në ATK për dy inspektorë G. J. dhe A. J., të cilët janë arrestuar nën dyshimet se kanë keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar. “Menaxhmenti i ATK-së siguron opinionin se çdo infor-

matë e dëshmuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe rasteve korruptive do të dërgohet në organet kompetente për trajtim dhe ndaj të gjithëve që shpallen fajtorë për vepra penale do të ndërmerren masat e largimit nga marrëdhënia e punës në

institucionin tonë. ATK falënderon qytetarët, mediat, Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për mbështetjen në luftimin e dukurive negative. Gjithashtu, fton qytetarët që për çdo rast të keqpërdorimit të detyrës zyrtare të raportojnë përmes linjës pa pagesë



0800 80 800 (burimi i informatave çdoherë do të jetë konfidencial)”, thuhet në njoftimin e ATK-së.

# Haziri, Kosumi e Kastrati flasin para studentëve për përpjekjet e shqiptarëve për liri e pavarësi

GJILAN, 14 SHKURT (ER) - Në vigjilje të 12-vjetorit shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka mbajtur një ligjëratë para studentëve të Universitetit "Kadri Zeka", ku prezentë ka qenë edhe rektori i këtij universiteti, Bajram Kosumi, kryetari i Kamenicës, Qendron Kastrati dhe autoritete të tjera.

Me këtë rast, Haziri ka folur për tri dekadat e mëdha, të cilat, sipas tij, kanë sjellë përpjekjet shekullore të shqiptarëve për të qenë të pavarur, të lirë dhe të barabartë. Ai ka thënë se këto dekada e kanë sjellë pavarësinë e Kosovës, që është zgjidhja më e mirë dhe e vetme, duke shtuar se këtë përpjekje gjenerata të tëra e kanë paguar shtrenjtë. "Dekada e parë 1980-1990 është

dekada e zgjimit për të qenë të barabartë. Kjo gjeneratë e kryengritësve të rinj, pra e studentëve, e zgjoi popullin për ta vazhduar rrugën e saj për liri. Në dekadën e dytë, përpjekja për liri nis me pajtim dhe kjo nuk e ka kuptimin vetëm të faljes së gjakut, por edhe faljes politike, pasi të prirë nga Ibrahim Rugova, të gjithë u bënë bashkë për ta ndërtuar dekadën e dytë '89-'99. Një unifikim të tillë që nuk e ka njohur historia deri në këtë rast, kulmoi me kryengritjen e viteve '98-'99, e pasoi me gjeneratën që e nisi kryengritjen. Dekada e tretë është ajo se si do të dukej Kosova, me një proces të ngadalshëm, me një mision ndërkombëtar për garantimin e paqes, negociatave të



stërzgatura për statusin final, për të kulmuar me shpalljen e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Angazhimin tonë politik deri në këtë finale e kemi bërë me unitet të plotë, pozitë-

opozitë. Është fat i madh që erdhi propozimi i presidentit Ahtisaari, që pavarësia e Kosovës është zgjidhja më e mirë", ka thënë Haziri. Ndërsa rektori i Universitetit

"Kadri Zeka", Bajram Kosumi, ka thënë se Lutfi Haziri ka qenë një nga protagonistët më të mëdhenj të shtetndërtimit, derisa ka folur për përpjekjet shekullore të shqiptarëve për liri dhe pavarësi. "Ne kemi qenë një popull i paragjykuar që të zhbëhet, por etërit tanë themelues, që nga Hasan Prishtina e deri tek Adem Jashari, nuk fjetën e nuk menduan për kënaqësinë e kësaj jete, ata e projektuan lirinë tonë rreth 100 vjet. Prandaj, sot u themi etërve tanë, ju faleminderit!", ka thënë Kosumi. Para të pranishmëve ka folur edhe kryetari i Kamenicës, Qendron Kastrati, i cili ka thënë se ata që kontribuuan për këtë ditë do të kujtohen gjithmonë me respekt maksimal.

## Braathu dhe Begaj përruruan zyrën e re të OSBE-së në Malishevë



MALISHEVË, 14 SHKURT (ER) - Shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu dhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kanë përruruar të premten zyrën e re të OSBE-së në Malishevë. Me këtë rast, shefi i misionit të OSBE-së, Jan Braathu, ka falënderuar kryetarin Begaj dhe Komunën e Malishevës për bashkëpunimin e mirë me këtë mision. Para përrurimit të kësaj zyre

ambasadori Braathu është pritur në takim nga kryetari Begaj dhe bashkëpunëtorët. Braathu ka falënderuar Komunën e Malishevës për bashkëpunimin e mirë dhe për përkrahje të ekipit komunal të OSBE-së. Po ashtu, ai e ka falënderuar këtë komunë për hapësirën dhe për rregullimin e zyrës së re të OSBE-së. Ndërsa kryetari Begaj ka thënë se me ekipin e OSBE-së jetojnë dhe

punojnë në një shtëpi prandaj, sipas tij, bashkëpunimi i ndërsjellë është i domosdoshëm. Gjithashtu, Begaj ka falënderuar shefin e misionit të OSBE-së, Jan Braathu, për bashkëpunim dhe për përkrahje të vazhdueshme për Komunën e Malishevës. "Ju falënderoj për punën që bëni këtu, për të cilën ne kemi nevojë të vazhdueshme", është shprehur Begaj.

## Lladrovci: Jemi të përkushtuar t'i ndihmojmë bizneset me qëllim të rritjes së punësimit

DRENAS, 14 SHKURT (ER) - Në Drenas të premten ka filluar seanca informuese në kuadër të projektit "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Ballkanin Perëndimor", projekt ky i cili financohet nga Qeveria gjermane dhe Komuna e Drenasit, ndërsa zbatohet nga organizata "Help Kosovo". Me këtë rast, kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka përhëndetur të pranishmit dhe ka inkurajuar që të jenë aplikues në këtë projekt që komuna i ka dhënë mbështetje edhe financiare. Lladrovci ka theksuar se Komuna e Drenasit është e përkushtuar t'i ndihmojë bizneset me qëllim të rritjes së

punësimit dhe të vetëpunësimit, zhvillimit ekonomik, përkrahjes së të rinjve për idetë e tyre inovative. Ndërsa përfaqësuesi i organizatës "Help Kosovo", Gent Saraçi, i ka informuar të pranishmit për formën e aplikimit për të fituar grantin. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, kurse format për aplikim janë marrë gjatë takimit informues, ndërsa ata të cilët nuk kanë mundur të marrin pjesë në këtë takim, takimi tjetër informues do të mbahet më 21 shkurt në sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit, duke filluar nga ora 10:00.



## Komuna e Prishtinës kërkon nga qytetarët ta ruajnë mjedisin

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se parkimi i veturave pa vend dhe dëmtimi i gjelbërimit është i dënueshëm.

Në këtë kontekst, kjo komunë ka kërkuar nga qytetarët që të kujdesen për mjedisin. "Respektimi i rregullave kush-ton më lirë. Parkimi pa vend

dhe dëmtimi i gjelbërimit është i ndaluar dhe dënohet me gjobë mandatore. Mbi të gjitha, nuk është sjellje e mirë qytetare! Të kujdesemi për

mjedisin ku jetojmë dhe të bëhemi shembull i mirë për brezat e rinj!", është thënë në apelin e Komunës së Prishtinës.



# VEPËR ME VLERË ENCIKLOPEDIKE NGA FUSHA E DREJTËSISË

(Sylë Kasumaj, "Fjalori i termave të drejtësisë", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, f. 816)

**Sadri FETIU**

Sylë Kasumaj, jurist i diplomuar me përvojë të gjatë punë në fushën juridike në gjykatë, në administratën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si edhe të punës shumëvjeçare në cilësinë e sekretarit administrativ të Institutit Albanologjik të Prishtinës, i ka hyrë me përkushtim të veçantë hartimit të një fjalori të madh juridik. Pas angazhimit dhe punës shumëvjeçare ai ka arritur që ta përfundojë me sukses "Fjalorin e termave të drejtësisë", i cili duke pasur parasysh kriteret përcaktuese gjithëpërfshirëse të lëndës dhe mënyrën e shpjegimeve të hollësishme të përmbajtjeve terminologjike mund të konsiderohet fjalor i mirëfilltë enciklopedik i fushës së gjerë të drejtësisë.

Duke u bazuar në literaturën përkatëse shkencore dhe profesionale, në fjalorët e ndryshëm terminologjikë, jo vetëm në gjuhën shqipe, në

dokumentet bazë të praktikave juridike të shteteve të ndryshme, ai i ka sjellë leksikologjisë sonë një vepër të plotë nga fusha e drejtësisë.

"Fjalori i termave të drejtësisë" i Sylë Kasumaj, që përfshin një gjashtë mijë zëra, mund të vlerësohet drejtë duke u bazuar në trajtimin e tij shumëdimensional. Së pari, brenda shpjegimeve të termave nga të gjitha fushat e drejtësisë shtrihet historiku i përgjithshëm i së drejtës në përgjithësi, duke filluar që nga kodifikimi i saj në praktikën e lashta kulturës së sumerëve të Mesopotamisë e Babilonisë, pastaj në kulturat e përgjithshme të lashtësisë, në mënyrë të veçantë në të drejtën romake, si edhe në ato të legjislacioneve të shteteve të ndryshme të Evropës, me theks të veçantë të traditën juridike franceze pas periudhës së Revolucionit Borgjez.

Përveç dimensionit historik ky fjalor përfshin edhe terminologjinë juridike nga fusha e të drejtës shqiptare, si në planin e formave të kodifikuara



juridiko-shoqërore e shtetërore, duke filluar që nga Statutet e Shkodrës (1345 - 1469) në të drejtën shtetërore shqiptare të periudhës perandorake, bizantine, sllavo-mesjetare dhe osmane, edhe e drejta tradicionale kanunore të shqiptarëve me një shtrirje shekullore deri në kohën tonë. Vend të veçantë në fjalor zë trajtimi i hollësishëm i terminologjisë së legjislacionit aktual në Kosovë dhe në Shqipëri.

Autori i "Fjalorit të termave juridike të drejtësisë", Sylë Kasumaj, për hartimin e teksteve është bazuar edhe në dokumente origjinale, në kodet civile e penale të shteteve të ndryshme, me theks të veçantë në ato të shtetit francez. Kur është fjala për dokumentet origjinale të shqiptarëve, si të Shqipërisë ashtu edhe të Kosovës, autori legjislacionin e tërësishëm të këtyre dy shteteve e ka trajtuar në hollësi duke përfshirë edhe shpjegimet e neneve të veçanta. Kjo metodë është zbatuar, duke filluar që nga e drejta kushtetuese e deri te e drejta religjioze dhe të drejtat e tjera personale të individëve në raporte të gjera familjare, shoqërore e shtetërore. Është meritë e veçantë e autorit që gjatë punës së tij ka arritur të ruajë një përpjesëtim të arsyeshëm të shprehjeve gjuhësore shqipe, duke u përpjekur për unifikimin e tyre. Bashkë me terminologjinë përkatëse në gjuhën tonë ai e ka ruajtur me kujdes edhe terminologjinë juridike

ndërkombëtare, e cila zbatohet në praktikën legislative të shteteve të ndryshme të Evropës. Gjatë hartimit të fjalorit autori ka përdorur literaturën e pasur juridike, si fjalorët e ndryshëm terminologjikë ashtu edhe tekstet shkencore e profesionale, si edhe burimet origjinale të teksteve ligjore, duke i zbatuar kriteret e përkufizuara standarde të citimit të kujdesshëm të burimeve të lëndës me anë të referencave përkatëse sa herë që është bazuar në veprat e autorëve të tjerë.

"Fjalori i termave të drejtësisë", i hartuar nga Sylë Kasumaj, është vepër që jo vetëm e plotëson një boshllëk të madh në këtë fushë, por edhe e pasuron leksikologjinë shqiptare. Kjo vepër do t'u shërbejë për punë të përditshme juristëve shqiptarë të të gjitha profileve, por do të jetë me interes edhe për lexuesit e rëndomtë që janë të interesuar për t'i zgjeruar njohuritë e tyre për të drejtën tradicionale shqiptare, si edhe për drejtësinë e zbatueshme të shqiptarët, si në Kosovë, po ashtu edhe në Shqipëri.

## NEXHMIJE PAGARUSHA, METEOR QË NDRIÇOI NË QIELLIN MBARËSHQIPTAR

**Tefta CAMI,  
ish-ministre e Arsimit  
dhe Kulturës**

Ndjeva dhimbje kur dëgjova lajmin se emblema e shkollës së këngës e të muzikës shqiptare ka ndërruar jetë. Natyrisht, vetëm fizikisht, sepse ajo na ka lënë pas mesazhin e pavdekësisë: "Ata që kanë punuar e punojnë për interesat kombëtare në të gjitha fushat e sektorët, kanë mbetur e mbeten gjallë në përjetësi në altarin e kombit shqiptar".

Na ka lënë zërin e saj melodioz me këngët e saj që do të dëgjohej e frymëzohen breza të tërë shqiptarë në pafundësi. Me zërin e saj të veçantë melodioz e të papërsëritshëm deri tani të qindra e qindra këngëve na ka përcjellë mesazhe filozofike të pafundme të bukurive e pasurive natyrore të trojeve shqiptare këtej e përtej Drinit, që ta duam atdheun dhe popullin tonë. Na ka dhënë mësim e mesazhe të fisnikërisë e burrërisë të shqiptarëve kudo ku jetojnë, të trimërisë e të heroizmit mbarëkombëtar ndër

shekuj në luftëra, për ta fituar lirinë e pavarësinë nga pushtuesit e huaj, për të gëzuar, si të gjithë popujt e Evropës dhe të Botës, lirinë, barazinë dhe vëllazërimin me vëllazërit e trojeve shqiptare të ndarë e përçarë në fillim të shekullit të kaluar nga Fuqitë e Mëdha, si asnjë popull tjetër në botë, në gjashtë shtete.

Kisha dëgjuar prej disa vitesh për këngëtarën e shquar shqiptare të Kosovës, Nexhmije Pagarushën. Në vitin 1979 u gëzova që m'u dha rasti si ministre ta pres e të bisedoj me përzemërsi me të në pritjen që i bëra Nexhmijes dhe këngëtarit të shquar Bashkim Paçuku nga Dibra e Madhe, tezja e të cilit, Siadeti, ishte bashkëshortja e axhës tim, si dhe disa instrumentistë. Ishin ftuar nga RTVSh për të bërë incizime të këngëve të fondit të tyre. Biseduam vëllazërisht, aq sa nuk e kuptuam sesi kaloi ora. Sa mirë kemi vepruar, që janë incizuar Nexhmija e Bashkimi në ato vite të lulëzimit të zërit të tyre që, me siguri, ruhen me shumë kujdes në fondin e Arkivit të RTVSh-së.



Nga RTVSh gjatë atyre viteve janë incizuar edhe shumë këngëtarë e instrumentistë të tjerë nga Kosova e viset e tjera shqiptare nga Maqedonia e Mali i Zi.


U lumturova që e takova përsëri Nexhmije Pagarushën kur shkova në Kosovë në vitin 2010, me rastin e 30-vjetorit të vizitës time si ministre e Arsimit dhe

Kulturës të RPSSH-së. U takuam te familja e të ndierit prof. Ymer Jaka, ish-sekretar i KE të Arsimit, Kulturës e Shkencës të KSA të Kosovës. Pavarësisht nga vitet që kishin kaluar, Nexhmija ruante po atë freski e bukuri, elegancë dhe gjallëri. Aty pata rastin të takoj e ngushëlloj nënën e Ymerit, Deten, e të shoqen Melihanë, si dhe Edi Shkriun

për babanë e saj, patriotin Muhamet Shukriun, i cili ka qenë nismëtari dhe organizatori i restaurimit të Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. U ngazëllyem me Nexhmijen, që u takuam përsëri në Kosovën e Lirë e të Pavarur, për të cilën kishim ëndërruar e punuar. Nexhmije Pagarusha me talentin e saj ka qenë e mbetet një flakadan, që jepte thirrje të fuqishme, për t'u ndezur zemrat e të gjithë shqiptarëve këtej e përtej Drinit për kushttrim e mobilizim për çlirimin e pavarësinë e Kosovës. E ka kryer me dinjitet misionin ndaj kombit shqiptar!

Me këtë rast u përcjell ngushëllimet e mia familjarëve e të afërmeve, miqve e shokëve dhe gjithë punonjësit të kulturës e të artit shqiptar për largimin nga jeta të misionares së këngës shqiptare, Nexhmije Pagarusha!

Lamtumirë dhe u prehsh në paqe, Nexhmije Pagarusha! Përkulem me nderim dhe respekt para jetës dhe kontributit të shquar të Nexhmije Pagarushës!



*Kompania Rajonale e Ujësjetjesit "Prishtina"  
sh.a. ua uron 12 vjetorin e shpalljes së  
Pavarësisë së Republikës së Kosovës*





Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

**KOSOVA**<sub>ERE</sub>



**URIME PAVARËSIA  
KOSOVË  
12 VJET SHTET**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA SKENDERAJ**



**12 VJET PAVARËSI**  
12 YEARS INDEPENDENCE  
12 GODINA NEZAVISNOSTI



*Të rënë në altarin e pavdekësisë, sollën Lirinë e Pavarësinë.  
Në jetësjmë amanetin e tyre, duke zhvilluar shtetin!*

**KRYETARI I KOMUNËS:**

*Bekim Fashari*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova**


MINISTRIA E EKONOMISË, PUNËSIMIT, TREGTISË, INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE INVESTIMEVE STRATEGHIKE  
MINISTARSTVO EKONOMIJE, ZAPOŠLAVANJA, TRGOVINE, INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I STRATEŠKIH INVESTICIA  
MINISTRY OF ECONOMY, EMPLOYMENT, TRADE, INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND STRATEGIC INVESTMENTS

**URJME KOSOVË**  
**12 VJET SHTET**

E rrallë

## 80-vjeçari i ve humb 200,000 dollarë nga një mashtrim në faqen e takimeve në internet

Një burrë i moshuar në Oregon, i ve, humbi 200,000 dollarë nga një mashtrim në internet. Gjithçka filloi kur një i paidentifikuar do të vidhte identitetin e një gruaje në Florida. Mashtruesi më pas përdori identitetin e vjedhur për t'u miqësuar me 80-vjeçarin përmes një faqe takimesh në internet. Në deklaratën e policisë thuhet: "I moshuari mori dokumente false që deta-



jonin kontratën me muzeun dhe deklaratat bankare. Duke u mbështetur në dokumentet dhe marrëdhënien e tij romantike, viktimja bëri një seri pagesash gjatë pesë muajve për individë të ndryshëm dhe llogari bankare jashtë shtetit që arrijnë më shumë se 200,000 dollarë".

FOTO E DITES



Në një qendër tregtare në Kinë njerëzit shihen me maska të vendosura në fytyrë pas përhapjes së koronavirusit /Reuters/

E jashtëzakonshme

## Shkencëtarët zbulojnë paraardhësin 'fantazmë' të njeriut në Afrikë

Një "popullatë fantazmë" misterioze e njerëzve të lashtë jetoi në Afrikën Perëndimore rreth 500,000 vjet më parë, besojnë shkencëtarët, gjenet e të cilëve mendohet të jetojnë në njerëz sot. Studiuesit thonë se ADN-ja nga ky grup përbën midis 2 për



qind dhe 19 për qind të prejardhjes gjenetike të Afrikës Perëndimore moderne, shkruan "BBC".

## BARSOLETA E DITËS



**Burri i thotë gruas:**  
- Nëse s' do të kisha ty do të humbisja.  
**Gruaja:**  
- Kaq shumë më dashuron?  
**Burri:**  
- Jo, por nuk e di rrugën për në shtëpi.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00

#### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

#### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.




**DASHI**  
Është një aftësi e shkëlqyeshme, prandaj mos e

anashkalo paralajmërimin që do të vijë në ndihmë, sidomos në negociata dhe transaksione financiare.



**DEMI**  
Mundohuni të mos konkurroni me partnerin tuaj dhe mos

iu dorëzoni tundimit për t'i treguar atij sa mirë jeni. Ngadalësoni ritmin tuaj dhe relaksohuni. Dilni, argëtohuni me miqtë.



**BINJAKËT**  
Duhet të ndaloni pak! Një fije maturie në biznes do

t'ju shmangë gabimet dhe zhgënjimet. Në punën, megjithatë, tregohuni fleksibël dhe të adaptueshëm.



**GAFORRJA**  
Do të eksperimentoni gjëra të reja dashurie

me partnerin tuaj dhe do të jeni në gjendje të paparë ta bëni veten unik në sytë e tij. As sektori profesional nuk është i keq. Urime!



**LUANI**  
Duhet të veproni me kujdes, t'i kushtoni

vëmendje asaj që thoni dhe të tregoheni tolerantë me njerëzit përreth jush. Dikush do të ndajë me ju një sekret të rëndësishëm.



**VIRGJERESHA**  
Në jetën tuaj do të ketë shumë

gëzim dhe zhurmë, brenda rregullave të shijes së mirë! Jeta si çift po lulëzon



**PESHORJA**  
Nuk do t'i jepni shumë rëndësi parave që largohen!

Në marrëdhënien në çift, erotizmi do të jetë si një magnet, i cili do t'ju bashkojë dhe do t'ju ndihmojë të shkoni përtej dallimeve të mendimit.



**AKREPI**  
Mos u shqetësoni shumë për pengesat e caktuara që

mund të jenë në rrugën tuaj. Me aftësinë dhe inteligjencën tuaj të zakonshme me siguri do të jeni në gjendje t'i kapërceni ato dhe të jeni të suksesshëm!



**SHIGJETARI**  
Kjo nuk është një ditë amatore! Yjet do t'ju

ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme, të cilat vetëm ata që janë në gjendje të pilotojnë mirë 'varkën' e tyre do të jenë në gjendje të përfitojnë plotësisht.



**BRICJAPI**  
Festa e Ditës së Shën Valentinit për ju do të

sponsorizohet nga një Hënë miqësore dhe pozitive në Akrep. Shumë surpriza të bukura ju presin në fushën sentimentale, nëse jeni në një lidhje serioze.



**UJORI**  
Në dashuri, nga njëra anë jeni kritik dhe shumë

kërkues dhe nga ana tjetër, ju ndjeni një dëshirë të fortë për liri dhe pavarësi. Bëni një ekzaminim të mirë të ndërgjegjes dhe rishikoni sjelljen tuaj!



**PESHQIT**  
Intuita, vendosmëria, mundësia,

përdorimi i mirë i përvojës dhe çështja në favor janë në menynë e ditës dhe janë shumë të dobishme në të gjithë sektorët.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Marmarinos: Dua të fitoj me Kosovën

Christos Marmarinos është prezantuar përzgjedhës i ri i "Dardanëve", kurse ai ka thënë se ndihet i nderuar që do të jetë në krye të Përfaqësueses së Kosovës. "Kam hasur në një mikpritje të ngrohtë nga drejtuesit e FBK-së dhe po ndihem shumë mirë. Jam i nderuar që do të drejtoj Kosovën dhe do të kem mundësi të punoj me lojtarët e Kosovës", ka thënë Marmarinos



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Përzgjedhësi i ri i Kosovës në basketboll, Christos Marmarinos, është prezantuar të premten nga drejtuesit e Federatës së Basketbollit. Numri një i FBK-së, Arben Fetahu, është shprehur i lumtur për marrëveshjen e arritur me Marmarinos, për të cilin ka thënë se është një trajner shumë ambicioz. "Christos është një trajner shumë ambicioz dhe me shumë njohuri për basketbollin modern. Është një kohë e shkurtër për të punuar me basketbollistët, pasi që ndeshjet ndaj Islandës dhe Luksemburgut janë shumë afër, por besojmë në aftësitë e tij. Shpresojmë se do të kemi suksese dhe bashkëpunimi do të vazhdojë edhe për një kohë më të gjatë", ka

thënë Fetahu. Para "Dardanëve", Christos Marmarinos është shprehur se ndihet i nderuar që do ta drejtojë Përfaqësuesen e Kosovës, duke mos hezitur të tregojë se synon të arrijë fitore. "Kam hasur në një mikpritje të ngrohtë nga drejtuesit e FBK-së dhe po ndihem shumë mirë. Jam i nderuar që do ta drejtoj Kosovën dhe do të kem mundësi të punoj me lojtarët e Kosovës. Për mua është një mundësi e mirë, por shpresoj se do të bëjmë një punë të mirë bashkërisht dhe do të kemi suksese. Synimi ynë është të fitojmë. Kemi dy ndeshje të vështira, por ne do të përqendrohemi në forcat tona dhe lojtarët që kemi", ka thënë Marmarinos. Ndërsa pjesë e shtabit teknik do të jenë Bujar Loci, Gyltekin Selimi, Dritëro Sefaja, Illmen Bajra,

Merkur Dobroshti, Kujtim Shala, Admirim Krasniqi, Granit Rugova dhe Edita Mendunjanin. Kosova do t'i fillojë përgatitjet më 17 shkurt, kurse ndeshjen e parë për parakualifikimet për Botërorin 2023 e zhvillon në Prishtinë më 20 shkurt ndaj Islandës. Tri ditë më vonë "dardanët" i pret një udhëtim i vështirë ndaj Luksemburgut.

## LISTA E PLOTË E KOSOVËS

Alban Veseli, Altin Morina, Dardan Berisha, Drilon Hajrizi, Edmond Azemi, Ergin Grosha, Erjon Kastrati, Fisnik Rugova, Gëzim Morina, Leonard Mekaj, Meriton Ismaili, Mikailë Tmusiq, Samir Zekiqi, Shawn Jones, Ujkan Karanezi, Urim Zenelaj dhe Valon Bunjaku.

## SHKURT

### Të martën shorti për gjysmëfinalen e Kupës

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se tërheqja e shortit për çiftet gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës do të bëhet të martën më 18 shkurt, në orën 12:00, në selinë e FFK-së. Pjesëmarrjen në këtë fazë të garave e kanë siguruar Prishtina, Ballkani, Drenica dhe Feronikeli. Në këtë fazë do të luhet me sistem vajtje-ardhje. Ndeshjet e para luhen më 8 prill, ato të kthimit më 22 prill.

### Sefaj përfaqëson Kosovën në Slloveni

Skitarja Enxhi Sefaj do ta përfaqësojë Kosovën në garën ndërkombëtare të FIS-it (Federata Ndërkombëtare e Skitarisë) "Pokal Loka 2020". Kjo garë mbahet të shtunën dhe të dielën në Skofja Loka të Sllovenisë. Sefaj do të marrë pjesë për grupmoshën U-14, ndërsa do të garojë në disiplinat e sllallomit dhe sllallomit të madh.

### Lala: Jemi në bisedime me disa klube për Milot Rashicën

Menaxheri i Milot Rashicës, Altin Lala, ka konfirmuar bisedimet me disa skuadra. "Ka palë të interesuara dhe ka pasur edhe diskutime. Duhet të jemi të përgatitur për të gjithë skenarët", ka thënë Lala. Vlera e sulmuesit të Kosovës, sipas "transfermarkt.de", edhe 35 milionë euro. Ndryshe legjenda e Gjermanisë, Dietmar Hamann, i rekomandoi Bayernit ta blinte Rashicën dhe jo yllin e Manchester Cityt, Leroy Sane.

### FFK-ja nënshkruan memorandum bashkëpunimi me FF të Katarit

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, po qëndron në Doha me ftesë të Federatës së Futbollit të Katarit. Ademi në aeroportin e Dohas është pritur nga zyrtarët e FF të Katarit si dhe nga ambasadori i Kosovës, Amir Ahmeti, derisa më pas në selinë e Federatës së Futbollit të Katarit është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit ndërmjet dy federatave nga nënkryetari i FF të Katarit, Saoud Al Mohannadi (që është edhe nënkryetar i Konfederatës Aziatike) dhe nga kryetari i FFK-së, Agim Ademi. "Ky memorandum përmban shumë fusha të bashkëpunimit, nga të cilat do të përfitojë futbollit i Kosovës si në aspektin sportiv, ashtu edhe në atë menaxherial dhe të marketingut", thuhet në njoftimin e FFK-së.

## Superliga rikthehet me derbi

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Pas një pauze të gjatë dimërore, sot (e shtunë) rikthehet IPKO Superliga e Kosovës në futboll me tri ndeshje interesante. Spikat përballja në mes të Ballkanit që është kampion vjeshtor dhe Drenicës nga Skenderaj. Kjo ndeshje zhvillohet në Suharekë dhe pritet me

interesim të jashtëzakonshëm për ta parë formën e djelmohave të Ismet Munishit, por edhe kuqezinjtë nën drejtimin e Gani Sejdiut. Prishtina në stadiumin "Fadil Vokrri" nuk pritet ta ketë vështirë ndaj Vushtrrisë, kurse Ferizaj e pret Feronikelin. Të dielën zhvillohet ndeshja kryesore

e kësaj xhiro, ku takohen dy skuadrat nga qyteti i Gjilanit, Drita dhe Gjilani. Ndryshe nga herët e tjera, kjo ndeshje zgjon interesim të madh për faktin se të dyja klubet synojnë titullin në këtë edicion garash. Në dy ndeshjet e tjera përballen Flamurtari - Trepça '89 dhe Dukagjini - Llapi.

## IPKO SUPERLIGA

**Të shtunën takohen:**  
13:00 Ballkani - Drenica  
13:00 Prishtina - Vushtrria  
13:00 Ferizaj - Feronikeli

**Të dielën takohen:**  
13:00 Drita - Gjilani  
13:00 Flamurtari - Trepça '89  
13:00 Dukagjini - Llapi





## Raiola: Pogba mund të kthehet te Juve, Ibra vendos vetë për të ardhmen

MILANO, 14 SHKURT - Paul Pogba mund të rikthehet te Juventus gjatë verës dhe konfirmimet vijnë nga vetë menaxheri i kampionit të botës, Mino Raiola. "Vendi i dytë i preferuar i Pogbas është Italia dhe nuk do t'i vinte aspak keq të rik-

thehej te Juventus. Megjithatë, ka kohë, pasi duhet të mbyllet sezoni dhe të luhet Kampionati Evropian, para se të kalojmë te vendimi për të ardhmen e tij", ka deklaruar Raiola. Më pas menaxheri i njohur ka folur edhe për dy klientë të vet, që

janë portieri i Milanit, Gigio Donnarumma dhe sulmuesi kryesor i kuqezinjve, Zlatan Ibrahimović. "Donnarumma është i qetë dhe i përqendruar të bëjë më të mirën e ta arrijë zonën Champions me Milanin, pasi kjo është shumë e rëndësishme. Për të

ardhmen e tij duhet të flasim edhe me klubin në lidhje me projektin dhe synimet. Sa i përket Ibrës, për momentin po argëtohet në fushë dhe në fund të sezonit do të jetë ai vetë që do të vendosë nëse dëshiron të vazhdojë apo të tërhiqet", ka shtuar Raiola.



## Dumoshi: Na pret Tokio, më të fortë se kurrë

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, të premtën ka pritur në takim kryetarin e Federatës së Xhudos të Kosovës, Agron Kuka, përzgjedhësin e Kosovës në xhudo, Driton Kuka, si dhe xhudistët që kanë fituar normën olimpikë për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Ministrja Dumoshi fillimisht ka urrear Distria Krasniqi për medaljen e artë dhe Nora Gjakovën për medaljen e bronzit në Grand Slamin e xhudos që u mbajt më 8 e 9 shkurt në Paris të Francës. Po ashtu, ajo u shpreh e lumtur për punën dhe suksesin që po e tregojnë xhudistët në gara të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. "Vajzat dhe djemtë tanë po na bëjnë krenarë me punën luftarake të tyre, në lojëra të ndryshme ndërkombëtare dhe ky suksese nuk do të ishte po të mos kishin mbështetjen dhe përkushtimin tuaj si trajner", ka thënë ministrja Dumoshi, duke theksuar faktin se me sukseset e arritura, xhudistët e Kosovës po i bëjnë nder vendit dhe po e promovojnë e forcojnë imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. "Unë si ministre mbetem e përkushtuar që të jem gjithmonë mbështetëse e fuqishme



e sportit. Duke pasur parasysh që këtë vit i kemi edhe lojërat olimpikë, është e rëndësishë së veçantë që vendi ynë do të përfaqësohet sa më suksesshëm me garuesit e saj në Tokyo të Japonisë duke dëshmuar edhe një herë që kemi talente në sport", u shpreh ministrja, duke u zotuar se MKRS-ja do t'i mbështesë sportistët për faktin se po i sjellin vendit medalje e suksese.

Ndërkaq kryetari Agron Kuka falënderoi ministren për pritjen dhe e uroi për marrjen e detyrës. Ai kërkoi nga ministrja Dumoshi që edhe në të ardhmen të vazhdojë bashkëpunimi i MKRS-së me

Federatën e Xhudos ashtu që bashkërisht të arrihen sukseset e synuara. Ministrja e drejtuesit e xhudos diskutuan edhe për çështjen e Qendrës Kombëtare të Xhudos e cila së shpejti do të fillojë së ndërtuari në qytetin e Pejës, për të cilën ministria do ta japë kontributin e saj në këtë drejtim. Ministrja Dumoshi, gjithashtu, ka thënë se shumë shpejt do t'i bëhet edhe zgjidhja e përcaktimit të lokacionit për vendosjen e shtatores së Majlinda Kelmendit, të cilën Federata Ndërkombëtare e Xhudos e ka sjellë në Kosovë për nder të xhudistes sonë me renome ndërkombëtare.

## Sot fillon sezoni pranveror në hendboll

PRISHTINË, 14 SHKURT - Sot (e shtunë) zhvillohen ndeshjet e para të stinorit pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Në pranverë pritet garë interesante për titull, por edhe për pozitat e tjera në tabelën e klasifikimit. Në kuadër të javës së 15-të ndeshja më interesante pritet të jetë ajo që luhet në Prizren në mes të Prizrenit e Trepçës (19:00). Prizreni është i teti me 7 pikë, por me pretendime për pozitë më të mirë. Trepça është e treta me 20 pikë. Kampionia dhe liderja e klasifikimit, Besa Famgas, është favorite ndaj Llapit në Podujevë (19:00), njëjtë si Prishtina ndaj Vushtrrisë (17:30). Vëllaznimi, po ashtu, llogaritet në dy pikë nga përballja me Dritën (16:00). Ndeshja në mes të Drenicës e Kastriotit luhet më vonë.

Në konkurrencën e femrave Istogu e pret Samadrexhën në hapje të stinorit pranveror në Superligën e



hendbollisteve. Në kuadër të javës së dhjetë, Istogu e Samadrexha takohen të shtunën (nesër) nga ora 16:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Istogu është kampion aktual, ndërsa stinorin vjeshtor e ka përfunduar në vend të parë me 16 pikë sa i ka edhe Ferizaj në vend të dytë. Njëjtë si Istogu edhe Vushtrria është favorite ndaj Dritës, ndeshje

kjo që, po ashtu, është të shtunën nga ora 16:00. Të shtunën luhet edhe takimi Shqiponja - Kastrioti (14:00), ku pritet të ketë më shumë rivalitet. Dy ndeshje të tjera janë të dielën. Ferizaj e pret skuadrën deçanase Jusuf Gërvalla, kurse Prishtina është mysafire e Vëllaznimit në Gjakovë. Të dy këto ndeshje fillojnë në orën 17:00.

### SHKURT

#### Bostoni fiton pas dy shtesave

Boston, 14 shkurt - Pas dy kohëve shtesë, skuadra e Bostonit fitoi me rezultat 141-133 ndaj Clippersave, duke ndalur hovin e ekipit nga Los Anxhelosi. Ndeshje me rivalitet dhe emocione gjatë gjithë kohës, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Në fund triumfoi skuadra e Celticsit, ku u dallua Jayson Tatum, autor i 39 pikëve, mbështetur edhe nga Smart me 31 pikë. Për Clippersat mirë u paraqit Leonardo, me 28 pikë e 11 rebounde, por që mbetën për statistikë. Mjaft e fortë dhe me emocione edhe sfida tjetër e luajtur në NBA, ku Oklahoma e mposhti me rezultat 123-118 New Orleansin. Sfidë e hapur deri në fund, ku për Oklahomën u dallua Gallinari, autor i 29 pikëve, ndërkohë që 45 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Për New Orleansin u dallua Zion Williamsoni, me 32 pikë, por që mbetën për statistikë.

#### Khabib: Për rivalët e mi vendos unë

Khabib Nurmagomedov, kampion i botës në peshën e lehtë, ka konfirmuar edhe një herë se nuk është në planet e tij një duel me Conor McGregor. Rusi do ta mbrojë në prill titullin kampion ndaj Tony Ferguson. Ndërkohë që pritet se fituesi i kësaj sfide do të duelojë me irlandezin, ide që është mbështetur edhe nga Dana White, presidenti i UFC-së. "McGregor pas Ferguson? Do të jem unë ai që do të vendos për rivalin e radhës dhe jo UFC-ja. Nëse dëshiron të dublojë sërish me mua duhet të zbresë në peshë dhe të fitojë 10 përballje radhazi dhe jo një. Për mua le të vazhdojë të duelojë me rivalë të dorës së dytë", u shpreh Khabib Nurmagomedov, që po përgatitet për duelin e radhës në kafaz.

#### Pele demanton të birin: Jam mirë

Disa ditë më parë djali i Peles deklaroi se i ati është i rënduar fizikisht dhe psikologjikisht, ndaj refuzon daljet në publik për shkak të gjendjes aspak të mirë shëndetësore, por vetë legjenda braziliane e futbollit ka përgënjeshtruar të birin. "Jam mirë dhe i përballoj më së miri limitet e mia fizike, ndonëse provoj të lëviz sërish topin. Faleminderit për lutjet dhe shqetësimet tuaja, por jam mirë. Këtë vit pres ta festoj përvjetorin e 80 dhe kaloj ditë të mira e të tjera jo aq të mira, por janë normale për moshën time", ka deklaruar Pele. Ai është shprehur se nuk e ka humbur aspak besimin te vetja dhe se respekton tërësisht agjendën e tij, ashtu si edhe limitet fizike për shkak të moshës.

#### Capello: Neymari duhet të marrë shembull nga Hamiltoni

Ish-trajneri i Kombëtares së Italisë dhe shumë klubeve evropiane, Fabio Capello, ka thënë se Neymari duhet ta kopjojë pilotin Lewis Hamilton. "Duhet të marrë shembull nga Lewis Hamiltoni, një sportist klasë. Neymari duhet ta imitojë. Ka nevojë të gjejë ekuilibër dhe qetësi, sepse cilësia e tij është jashtëzakonshme. Mendoj se ai dhe Mbappe do të duelojnë për Topin e Artë pas Ronaldos dhe Messit. Neymari duhet të kuptojë gjithashtu se roli i tij shkon përtej fushës. Ai është një shembull për të rinjtë dhe ka një rol edukues, ndaj duhet t'i kushtojë vëmendje edhe këtij aspekti", ka thënë Capello.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,*  
*Ministri of Education, Science and Technology*

Departamenti i arsimit parauniversitar  
 Departament preduniverzitetskog obrazovanja

### Njoftim

Ju njoftojmë se, anulohen pozitat për: Mësues klase në shkollën speciale "Shpresa" në Shtime, në konkursin e shpallur të mërkurën, 25.12.2019, në gazetën ditore "Bota Sot" dhe "Epoka e re", për vendet e lira të punës në Qendrat Burimore.

Pikat tjera të konkursit vazhdojnë me procedura.


Faleminderit për mirëkuptim!

### Obaveštenje

Obaveštavamo vas da se pozicija za: razredni učitelj u specijalnoj školi "Shpresa" u Štimlje, na konkursu objavljenom u sredu, 25.12.2019, u dnevnom novinama "Bota Sot" i "Epoka e Re" za slobodna radna mesta u Resornom centru.

Ostale tačke konkursa nastavljaju prema proceduri.

Hvala na razumevanju!



### Shpallje Publike

Sipas nevojave të paraqitura për angazhimin e punëmarrësve për punë specifike në Kabinetin e Drejtorit Menaxhues, bazuar në Ligjin e punës nëni 10 pika 2, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 14.02.2020 publikon vendet e lire për pozitën e më poshtme:

#### Këshilltar Strategjik për projektet e përbashkëta me donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare (Për punë specifike në kohëzgjatje për 4 muaj)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Bartësi i punës do të jetë përgjegjës për zhvillimin e bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare në funksion të financimit të projekteve prioritare të korporatës. Identifikimin e projekteve potenciale për financim nga institucionet financiare ndërkombëtare. Kontribuojë në qasjen strategjike zhvillimore të korporatës komfor zhvillimeve dhe trendit të politikave në sektorin e energjisë me qëllim të integritimit dhe rritjen e aftësisë konkurruese të korporatës në tregun rajonal dhe më gjere. Kontribuojë në zhvillimin e projekteve në funksion të diversifikimit të portfolios se aktiviteteve të korporatës me theks të veçantë në BRE-ve. Përgatit dhe ndërton politike dhe procedura standarde për qasje në fonde në institucionet të ndryshme financiare ndërkombëtare dhe jo vetëm.

Është i obliguar ta ruaj sekretin afarist të korporatës.

#### Kërkesat profesionale/ Kualifikimet

Përgatitja superiore nga lëmia: Ekonomisë, Financave ndërkombëtare, Energjisë, minimumi niveli master. Të ketë se paku 10 vite përvojë të punës. Së paku 5 vite përvojë punës në zhvillimin dhe negociimin e projekteve me institucionet financiare ndërkombëtare. Të ketë njohuri mbi zhvillimet dhe politikat në sektorin e energjisë në Kosovë si dhe Bashkimin Evropian. Preferohet njohja e gjuhëve të huaja, obligative njohja e gjuhës Angleze në të folur dhe të shkruar si dhe përparësi në njohjen e gjuhës Gjermane. Përparësi kandidatë me përvojë pune në projektet e donatorve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare në sektorin e energjisë. Përparësi kandidatët me pozita të njëjta në të kaluarën.

Te dëshmoj nivel të lartë të etikës profesionale

**Si të aplikohet:** Për hollësitë e mëtutjeshme për pozitat e lartpërmendura shikoni në faqen e internetit të KEK-ut [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com). Aplikacionin të cilin e gjeni në faqen tone të internetit të dërgohen në adresë [ofertapune@kek-energy.com](mailto:ofertapune@kek-energy.com).

Prishtinë, 14.02.2020

Data e aplikimit deri 28.02.2020



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Fortesa" Sh.p.k Korishë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatin, thërrmimin dhe seperimin e gurit eruptiv në "Osojë" komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.03.2020 në ora 11:00 në hapësirat e zyrave të subjektit "Fortesa" Sh.p.k në fshatin Korishë komuna e Prizrenit (magjistranja Prizren - Suharekë tek fshati Korishë) do të organizohet debat publik nga kompania "Fortesa" Sh.p.k Korishë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatin, thërrmimin dhe seperimin e gurit eruptiv në "Osojë" komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti  
 Ministria e Shëndetësisë  
 Ministrystvo Zdravstva-Saglık Bakanligi  
 SHSKUK - UBIŠKI KURRI  
 SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE  
 "Frim. Dr. Daut Mustafa"

Njësia Org. I Nr. Prot. 8/11  
 Org. Jeticia Nr. Prot. 1  
 Org. Dëltimi Nr. Prot. 14.02.2020  
 Nr. i faqesë 1  
 Brastanica Datum  
 Sayfa no. P R I Z R E N Tarih:

Datë: 14.02.2020  
 Lënda: Anulim

Bazuar në shkresën e drejtorit të përgjithshëm të SHSKUK-së, të datës 14.02.2020,  
**ANULOHE**  
 Pika 3 (mjek specialist i oftalmologjisë) e konkursit publik nr. 8/5 të datës 07.02.2020

Drejtoresha e Administratës

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Agron Shaqiri, shpall të pavlefshme dëftesën e kl. VIII. SHF "Abedin Rexha" Turiqevc.
- ▶ Enver Spahija, shpall të pavlefshme dëftesat (kl. I - VIII) SHF "Shote Galica" Runik.
- ▶ Selviqe Arllati, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I, II, III. te SHMLT "Arkitekt Sinani" Mitrovice.
- ▶ Imer Totaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Zenun Çoçaj" Gjonaj
- ▶ Verije Omaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur
- ▶ Kreshnik Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Fadil Hisari" Prizren
- ▶ Emir Ibrahim shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Florent Thaqi (Elton Sokoli) shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shm "Ukshin Hoti" Krushë e Madhe.
- ▶ Agron Dina shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Kushtrim Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Zef Lush Marku" Velezh.
- ▶ Munker Tac shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Emin Duraku" Prizren.
- ▶ Erblin Tanushaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Emin Duraku" Prizren.
- ▶ Avni Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dy Dëshmoret" Piranë
- ▶ Blerina Fetaj shpall të pavlefshme INDEX-in, e Kolegjit FAMA, Prishtinë.
- ▶ Adriatik Hoxhaj. Shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.
- ▶ Arjent Kukaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA, A.D.

**kostt**

**GËZUAR**

**12 VJET PAVARËSI**



**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkurseve, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 15.02.2020 të shpall:

**KONKURS PUBLIK**

Për plotësimin e vendeve të punës:

**5(pesë) Punëtor Fizik** -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë shkollën fillore ose së paku një vit përvojë pune
- Të prezantoj letërnjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj)

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 15.02.2020 deri më datën 29.02.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



## Njoftim për tatimpagues

**ATK, ju rikujton aplikimin e ngarkesës së kundërt të TVSH-së në furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit**

Administrata Tatimore e Kosovës, ju rikujton se në muajin dhjetor/2019 ka nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 03/2019 - Detyrimi për të paguar TVSH-në për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit – Aplikimi i ngarkesës së kundërt.

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj trajtimin tatimor për aspekte të TVSH-së për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit, respektivisht aplikimin e ngarkesës së kundërt (Reverse Charge) për TVSH, brenda vendit.

Shërbimet ndërtimore të ofruara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm, trajtohen sipas Vendimit Shpjegues Publik Nr. 03/2019.

Vendimin Shpjegues Publik Nr.03/2019 - Detyrimi për të paguar TVSH-në për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit – Aplikimi i ngarkesës së kundërt, mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) në linkun Publikime.

*ATK, në implementim të Projektit  
“Përmbushja në Sektorin e Ndërtimtarisë”!*

**Administrata Tatimore e Kosovës**



Opstina Strpce

Opstinsko Odeljenje Obrazovanja, Kulture, Omladine i Sporta

Na osnovu Zakon o Radu br.03/L-212 član 8: Zakon o Preduniverzitetskom Obrazovanju Republike Kosova 04/L-032, član 35 paragraf 1, 4 i 5; Zakon br. 03/L-068 za Obrazovanje u Opstinama Republika Kosova, član 5 tačka c; Administrativno Uputstvo (MRSP) 07/2017; Administrativno uputstvo 10/2018 (MONT), Opstinsko Odeljenje Obrazovanja, Kulturu, Omladinu i Sport objavljuje:

### KONKURS

ETS “Jovan Cvijic” Strpce

Naziv radnog mesta: Ekonomski predmet

Broj casova: 20

Koeficient: A-459/1

Broj preporuka: 08-111/01-2058/20

Opis radnog mesta:

Da realizuje zadatke rada obezbedjujući kvalitet i profesionalnu kompetentnost u procesu nastave.  
Da redovno sprema nastavni, godišnji, mesečni i dnevni plan u skladu sa Karikulom, i u skladu sa zahtevima za prilagodavanje nastave sposobnostima i individualnim mogućnostima svakog učenika.  
Da ima znanje za jedan širi repertoar nastavnog stila, i da je u stanju da ih upotrebi, da što bolje odgovara situaciji u učionici.  
Da na efikasan način iskoristi izvore koje ima na raspolaganju.  
Da planira, vodi, posmatra učenje i ponašanje svakog učenika.  
Da realizuje nove metode nastave i proceni u saglasnosti sa uputstvima karikul.  
Da stvori atmosferu rada i discipline, bez upotrebe kaznenih metoda ili neke druge forme ponižavanja učenika.  
Da redovno kontroliše i vodi evidenciju o uspehu i individualni napredak svakog učenika, da je u stanju da obaveštava roditelje ili staratelje deteta direktno o postignutom uspehu učenika, prema zahtevu.  
Da zainteresuje učenike da uče i ohrabri ih da samostalno uče.  
Da se brine o stalnom profesionalnom razvoju osobe, prema predviđenom planu i da se brine za realizaciju istih.  
Da je u stalnom kontaktu sa roditeljima svakog učenika, ostvarujući osobne sastanke sa roditeljima/ staraocima deteta.  
Da pomogne kolege na povećanju kvaliteta rada.  
Da uzme aktivni deo u pripremi programa i školskim događajima, kada se to zahteva od direktora škole.  
Da uzme aktivno učešće u vanškolskim događajima sa ucenicima, i da realizuje sa odgovornošću ekskurzije, unutar ili van Zemlje, prema uputstvu direktora škole.  
Da pokaže poštovanje, kolegijalno ponašanje i ne ponižava kolege sa kojima radi.  
Da održava dežurni čas i dnevno dežurstvo.  
Zaposleni je obavezan da poštuje kod oblačenja i ponašanja, predviđen unutrašnjim pravilnikom škole.

Uslovi konkursa:

Za radon mesto trazi se strucna odgovarajuca kvalifikacija, prema **AU. br. 10/2018 (MONT)**

Potrebna dokumentacija za konkurs:

- Diploma
- Izvod rođenje
- Licna karta
- Potvrda iz suda

Rok trajanja ugovora pocinje od dana rada do 31.08.2020

Aplikacije se mogu uzeti u OOO ili u skoli i predaju se (sapotvrđenim dokazima o kvalifikaciji) u objektu Opstine Strpce, kancelarija br.28.

Aplikacije koje se predaju posle predviđenog roka nce se primiti, dokumentacije nepotpune aplikacije ce se odbiti.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana javnog objavljivanja : od 15.02.2020 do 01.03.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 6 para 1 pika 1.2, nenit 8 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr-463-14811 të datës 04.03.2019, Vendimit të Kuvendit të komunës 15Nr.463-48449 të datës 19.07.2019 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve dhe dhe Vendimit të Kuvendit të komunës Nr.15-020-79227 të datës 20.12.2019 për zëvendësimin e antarëve të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK  
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME  
TË KOMUNËS**

Komuna e Lipjanit, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr.463-14811 të datës 04.03.2019 dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48449 të datës 19.07.2019, i jep në shfrytëzim në afat prej gjashtëmbëdhjetë (16-të) viteve pronat e paluajtshme të Komunës të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve, siç përcaktohen në tabelën në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura -klasa	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
1	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-9	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	22040
2	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-10	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	16395
3	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-11	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	36732
4	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-12	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	30000
5	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01977-4	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	5899
6	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-3	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	18335
7	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-5	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	14400
8	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-6	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	1600
9	Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00559-5	Babush i Muhaxherëve	Bujqësore-kullosë kl.4-të	5875

Dhënia e pronave të cekura më lartë jepen me qëllim të shfrytëzimit të shkëmbinje-seperimit të gurëve apo të ngjashëm, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro), për çdo parcelë kadastrale të ofertuar ndërsa për secilën parcelë nevojitet kuvertë ose zarfë e veçantë, dhe jashtë kuvertës në njëren anë duhet të shënohet Zona Kadastrale, ---Gadime e Ulët – Babush i Muhaxherëve.

Njoftohen aplikuesit, se hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë 03.03.2020 duke filluar në ora 10:00 .

**Kriteret për zgjedhjen e ofertave**

Zgjedhja e ofertës bazohet në kriteret vijuese:

- Projekti tekniko-investiv, programi i propozuar për shfrytëzimi, është i bazuar në praktikën më të mirë të shfrytëzimit dhe mbrojtjes së mjedisit në pajtim me legjislacionin në fuqi
- Vlera e investimit për periudhën për të cilën aplikon
  - Numri i të punësuarve nga investimi
  - Lloji i investimit që është me interes për Komunën
  - Interesi financiar i Komunës
  - Kompania duhet të ketë licencën e shfrytëzimit, për pronat-parcelat për të cilat konkuron-aplikon, sipas kriterëve të përcaktuar në Ligjin për Miniera dhe Minerale
  - Rruga deri në punishtë të asfaltohet dhe të mirëmbahet me qëllim të ruajtjes së ambientit
  - Pesha e automjeteve transportuese-kamionëve në rrugët lokale duhet të jetë sipas kufizimeve të përcaktuara.

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij konkursi, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vulloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar.

Kuverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme  
të Komunës së Lipjanit për Njoftimin publik**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.2 në formë fizike, dhe në formë elektronike nga Webfaqja e Komunës .

Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi.

Ofertat të pakompletuara të paprecizuara, të panëshkruara nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.


Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i dytë - zyrë Nr.106 dhe 107 Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

Nr. 15-163-9337

Me datë: 13.02.2020

Kryesuesi i Komisionit

Bekim Shabani



# SHOQATA PËR KTHIMIN E SHQIPTARËVE TË SHPËRNGULUR NGA TROJET E TYRE

**Sheshi 21, Prishtinë**  
**15 shkurt 2020**

**30**   
**VJETORI**



**Ndarja e Çmimit**  
**"HASAN PRISHTINA"**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
Univerziteti i Klinike Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
**Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital**  
**“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA”**  
Prizren

Bazuar në nenin 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe kërkesës për rekrutim nr.2/12, të datës 21.01.2020, të aprovuar nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, Dr. Basri Sejdiu, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

**KONKURS PUBLIK**  
Për pranimin në marrëdhënie pune

Titulli i vendit të punës:  
**Teknik i Radiologjisë Bachelor (2 vend pune)**  
Norma e punës: Orar i plotë  
Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore  
Numri i referencës: 8/10, dana 14.02.2020

**Vendi i punës - Teknik i Radiologjisë-Bachelor**

**Qëllimi i pozitës:** ofron shërbim të standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët.  
**Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:** Zbaton dhe dokumenton kujdesin e pacientëve me kushte të ndryshme të sëmundjes sipas standardeve të punës; Monitoron dhe transporton pacientin me vështirësi në lëvizje për ekzaminime të ndryshme brenda institucionit; Kujdeset për sigurinë e pacientit dhe monitorimin e vazhdueshëm të tij; Ndihej në orientimin e punëtorëve të rinj në punë dhe organizimin e punës për nxënësit dhe studentët në praktikë; Edukon kolegët dhe vetveten në lidhje me kryerjen e detyrave të punës; Realizon aktivitete përmes punës ekipore; Bashkëpunon me profile të tjera profesionale në menaxhimin e pacientëve; Bashkëpunon me punëtorë nga njësitë tjera të institucionit; Rregullon, pastron dhe mirëmban hapësirën e punës, rrethinën e pacientit, pajisjet, instrumentet dhe mjetet e tjera të punës (përgatitja për punë, kontrolli i rendit të punës, pastrimi, dezinfektimi dhe magazinimi pas përfundimit të ditës së punës); Trajton me kujdes racional dhe të saktë materialin, pajisjet, mjetet dhe veglat e punës; Përgatit materialet dhe mjetet e punës për përdorim dhe intervenim; Mbron pronën në vendin e punës kundër vjedhjes, zhdukjes, dëmtimit dhe shkatërrimit; Kryen detyra të tjera të punës sipas rendit të punës ose punët e mbetura nga ekipi i ndërrimit paraprak, ose punë tjera të kërkuara prej kryeinfermierës ose shefit të repartit; Cakton, planifikon, implementon dhe vlerëson kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me praktikën klinike të aprovuara; Mbledh dhe proceson të dhëna të sakta mbi pacientin; Siguron komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët e përkujdesur gjatë orarit të tij/saj të punës. Ndan informata të sakta për pacientët lidhur me kujdesin që ju ofrohet; Administron terapinë e përshkruar në përputhje me praktikën klinike institucionale; Asiston në hartimin e udhëzuesve dhe procedurave të shkruara mbi punën e profesionale sipas nevojës; Merr pjesë në mbledhjet e ekipit kur është e nevojshme; Merr pjesë në aktivitetet e organizuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informatave në mes të personelit shëndetësor; Ruan konfidencialitet të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur autorizohet me shkrim, në përputhje me rregullat institucionale; Merr pjesë në aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike.  
**Detyrat specifike:** Ndihej në lëvizjen dhe ngritjen e pacientëve të palëvizshëm ose pjesërisht të lëvizshëm; Bën përgatitjen e materialit, dezinfektimin dhe sterilizimin e tij; Pastron, dezinfekton, përgatit dhe ndihmon në kujdesin e pacientit; Bën përgatitjen e pacientit për intervenim kirurgjik nga aspekti higjienik dhe procedurave tjera të nevojshme para intervenimit; Bën bartjen e pacientit nga reparti deri në traktin operativ me mjetet dhe veshmbathjen e nevojshme për çelje dhe me dokumentacion të kompletuar; Në rastet e caktuara, merr pjesë si përcjellës në referimin e pacientëve jashtë repartit si dhe në nivelin terciar; Menaxhon dokumentacionin mjekësor dhe largimin e tij nga njësia organizative ku punon; Kujdeset për dietën e pacientit. Kryen dhe detyra tjera sipas nevojës.

**Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës nr.5: Teknik i radiologjisë Bachelor**

**Dokumentacioni i kërkuar:**

1. Diploma Teknik i Radiologjisë Bachelor – (origjinal apo kopje e vërtetuar)
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë valide (origjinal apo kopje e vërtetuar)
3. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
4. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
5. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)

**Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim për të gjitha pozitët:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe i plotësojnë kushtet sipas konkursit për vendin e punës për të cilin aplikojnë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik

Aplikacioni merret në zyrën nr.1 të Administratës së Spitalit së bashku me përshkrimin e detyrave të punës. Aplikacioni me dokumentacion përcjellës dorëzohet në Administratë-zyra e personelit, çdo ditë pune nga ora 7:00-15:00h. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa, aplikacionet e mangëta refuzohen.

Na osnovu član 13, tačka 1.1. Statuta Bolnice, člana 8 Zakona br. 03 / L-212 o radu, Administrativnog uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o regulisanju procedura javnih konkursa, kao i prijava za zapošljavanje br. 2/12, dana 21.01.2020, odobrena od strane generalnog direktora KSHKUK, Dr. Basri Sejdiu, Upravni odbor Opšte bolnice objavljuje:

**Javni Oglas**  
Za prijem u radni odnos

Naziv radnog mesta :  
**Tehnicar radiologije Bachelor (2 pozicija)**  
Radni standard: Puno radno vreme  
Trajanje ugovora: Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca

Broj referce: 8/10, Dana: 14.02.2020

**Radno mesto - Tehnicar radiologije bachelor**

**Svrha radnog mesta:** Pruža najviši standard zdravstvenih usluga usmerenih na pacijenta, obezbeđujući u svakom trenutku pravilnu i sigurnu negu pacijenata.

**Radne obaveze i odgovornosti:** Implementira i dokumentira negu pacijenata sa različitim bolestima u skladu sa standardima rada; Nadgledati i prevoziti pacijente sa oštećenjem mobilnosti na razne preglede u instituciji; Pomaže u orjentisanju novih radnika za rad i organizovanju rada za studente i studente u praksi; Edukuje kolege i sebe o obavljanju zadataka; Izvodi aktivnosti timskim radom; Saraduje sa drugim profesionalnim profilima u upravljanju pacijentima; Saraduje sa zaposlenima iz drugih jedinica institucije; Uređuje, čisti i održava radni prostor, okruženje pacijenata, opremu, instrumente i druge radne alate (priprema posla, kontrola radnog naloga, čišćenje, dezinfekcija i skladištenje po završetku radni dan); racionalna i precizna briga o materijalima, opremi, alatima i alatima; Priprema materijala i alata za upotrebu i intervenciju; Štiti imovinu na radnom mestu od krađe, nestanka, oštećenja i uništenja; Obavlja druge radne zadatke po nalogu posao ili posao koji je napustio tim pre smene ili drugi posao koji zahteva medicinska sestra ili šef osoblja; Zadaje, planira, sprovodi i procenjuje negu pacijenata u skladu sa odobrenim kliničkim praksama; Prikuplja i obrađuje tačne podatke o pacijentu; Obezbeđuje dobru komunikaciju tokom dodele poštanskog ureda kao i tačne podatke o pacijentima o kojima se brine tokom radnog vremena. Pruža tačne informacije pacijentima o pruženoj nezi; opisano u skladu sa institucionalnom kliničkom praksom; Pomaže u izradi smernica i postupaka pisano o stručnom radu po potrebi; Pohada sastanke tima po potrebi; Učestvuje u aktivnostima organizovanim za razmenu znanja i informacija između zdravstvenog osoblja; Održava potpunu poverljivost u vezi sa pitanjima koja se tiču postupanje sa pacijentom ili radom ustanove, osim ako je to pismeno ovlašćeno, u skladu sa institucionalnim pravilima; Učestvuje u kontinuiranom profesionalnom obrazovanju radi ažuriranja i unapređenja znanja i standarda sestrinskog rada. Specifični zadaci: Pomaže u kretanju i montaži stacionarnih ili delimično pokretnih pacijenata; Priprema materijal, dezinficira i sterilizira; Čisti, dezinficira, priprema i pomaže u nezi pacijenata; Priprema pacijenta za higijensku intervenciju i drugi potrebni postupci pre intervencije; Prebacivanje pacijenta iz odeljenja u operativni trakt sa potrebnom pratećom alatkom i odecim i kompletnom dokumentacijom;

Vodi medicinsku dokumentaciju i uklanja iz organizacione jedinice u kojoj radi; Vodi računa o ishrani pacijenta. Po potrebi obavlja i druge zadatke.

**Potrebne kvalifikacije za radno mesto br.5: Završeni fakultet Tehnicar radiologije Bachelor**

**Potrebna dokumentacija:**

1. Diploma fakulteta - tehnicar radiologije Bachelor - (original ili overena kopija)
2. Važeća radna dozvola Ministarstva zdravlja (original ili overena kopija)
3. Izvod iz matične knjige rođenih (original ili overena kopija) i fotokopija lične karte
4. Potvrda da niste osuđeni ili ste pod istragom (original ili overena kopija)
5. Potvrda o zdravlju (nakon primanja u radni odnos)

**Uslovi za prijem u rekrutaciju za sve pozicije:** Pravo na rekrutaciju imaju svi državljani Republike Kosova koji su završili adekvatnu spremu za radno mesto za koje konkurisu.

Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim medijima.

Aplikacije se dobijaju u administraciji bolnice. Prijava sa pratećom dokumentacijom se podnosi Upravi bolnice u Prizrenu, ulica "Sheh Emini" str. svakog radnog dana od 7:00 do 15:00. Prijave podnesene nakon isteka roka nisu prihvaćene, dok su nepotpune prijave odbijene.

Prizren, 14.02.2020

Direktor Administracije  
Melinda Collaku, Mr.sci. e Juridikut



## OFERTË SPECIALE

**PAKOT E KOMBINUARA**

**BLEJ PAKOT FOL & INT PËRFITO EKSTRA 2GB INTERNET**

**PAKOT E INTERNETIT**

**BLEJ PAKOT E INTERNETIT PËRFITO DYFISHIN E GB**



**FESTO ME VALA!**  
**ËSHTË E KOSOVËS!**



0800 10000  
[www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com)

OFERTA PROMOCIONALE VLEN NGA 17 SHKURT DERI MË 21 SHKURT

*Urime Dita e Pavarësisë*

